



www.fqurani.com

KËSHILLA

Përmbajtja/ Korrik 2012 (Nr. 43)

Do të lexoni:

-  **Përse agjërojnë myslimanët** **5**
-  **A e doni lumturinë?** **19**
-  **Fitimtarët e Ramazanit** **31**
-  **Gënjeshtër te fëmijët** **43**
-  **Gruaja dhe Facebook-u** **46**
e të tjera...

Rubrika për fëmijë "Selam" përmban: "**Kali i egër**", "**Më bujar se Hatemi**", "**Kujtimet e mia**", "**Kuriozitete**" e të tjera...

KËSHILLA

Nr. 43, Korrik, 2012
Organ i Fondacionit të Kur'anit

Drejtör:
Prof. Muhammed Reza
HAXH KHEZR

Kryeredaktore:
Liseda RAMAJ

Drejtör artistik:
Vullnet MERJA

Korrektori:
Vjollca KARAJ (FEZA)

Design & Layout:
Aurora SHEHU

Bashkëpunëtorë:
Vullnet MERJA
Vjollca KARAJ (FEZA)
Sabrie FEZA
Selim STAJA
Majlinda NDRECA
Jefmir CELA etj.

Përgjegjëse për rubrikën
"Selam": Mina Mekami
Bashkëpunëtorë:
Rejhane Ikbali
Fatime Haxh Khezer
Mina Mekami
Sabrie Feza

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim Nr. 168
Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 04 -2 377 311
Tirana – Albania
WebSite: www.fqurani.com
E-mail: f_quran114@yahoo.com



Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Rifreskimi i betimit ndaj Zotit

Ramazani është stina e pranverës e mbushur me mirësi e virtyte, ku e mira lulëzon në të gjithë bashkësitë myslimane anekënd. Gjatë Ramazanit besimtarët e mbushin kohën duke kërkuar mëshirën e Allahut, falje dhe mbrojtje nga zjarri i Xhehenemit. Ky është muaji në të cilin e rifreskojmë zotimin dhe e forcojmë akoma më tej lidhjen me Krijuesin. Si çdo Ramazan, lutjet, urimet, fjalët nuk kanë fund, por përherë, çdo Ramazan ka veçantinë e vet. Në çdo vit që kalon, njeriu ndihet ndryshe e kjo, vetëm pse zotimi që i kemi bërë Krijuesit një vit më parë duhet të ishte përmbushur e tashmë ka ardhur radha për një zotim të ri. Kështu, nga viti në vit, Ramazani na gjen njerëz më të mirë e më të drejtë. Përveç mirësive të shumta e begative të këtij muaji, është edhe dikush që bëhet gati të largohet, sepse Ramazani po vjen. Është shejtani që prangoset në Ramazan. Por njeriu sërish duhet të jetë i kujdesshëm e ta shfrytëzojë sa më mirë këtë mirësi të Allahut. Qëllimi parësor i këtij muaji është pastrimi i trupit dhe i shpirtit të njeriut. Agjërimi është bindje e besimit të vërtetë, pa dyfityrësi e hipokrizi. Njeriu që agjëron është gjithmonë i dhembshur dhe bujar. Allahu nuk ka nevojë për urinë tonë, por ne kemi nevojë për shpërblimin e Tij. Ne kemi nevojë për Xhenetin; jemi ne ata që ngulmojmë që nëpërmjet agjërit të hyjmë në Xhenet.

Por vallë, a është agjërimi një mënyrë për të hyrë në Xhenet? A është agjërimi rrugë që të dërgon tek dëshira më e madhe e besimtarit? Vëlla ose motër e dashur, a ke dëshirë ti që Allahu të të falë ty? A dëshiron që të shpëtosh nga dënimi i dhembshëm i Xhehenemit (zjarrit)? A dëshiron ti që melekët të kërkojnë falje për ty tek Allahu i Madhëruar? A dëshiron ti që të përgatitet për ty Xheneti dhe të hysh pa patur frikë? Nëse i do të tëra këto, atëherë duhet që ta agjërosh muajin e shenjtë të Ramazanit.

Zoti në Kur'an thotë: *"O ju që besuat, agjërimi u është bërë detyrim sikurse që ishte detyrim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. Jeni të detyruar për ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të detyruar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri. Ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju. Ato ditë të numëruara janë Muaji i Ramazanit, në të cilin (filloi të) shpallej Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun se u udhëzoi dhe që të falënderoni."* ("El-Bekare", 183-185)

Kryeredaktorja



Me rastin e muajit të bekuar të Ramazanit,
muajit të pages, të vëllazërimit
dhe të zbritjes së Kur'anit të Shenjtë,
Fondacioni i Kur'anit
ju uron agjërim të lehtë e të pranuar
tek Allahu (që goftë i Madhëruar!)

Muhammed Reza Haj Khezr
Drejtore i Fondacionit të Kur'anit.



Përse agjërojnë myslimanët?

...agjërimi është veshje me mburojën e pastërtisë kundër pasioneve të dynjasë. Ai do të thotë që trupi të përfshihet edhe "fizikisht" në pastërtinë e vdekjes, e cila natyrisht shoqërohet me lindjen shpirtërore

Pa një element sakrifice dhe asketizmi asnjë fe, e kësaj asnjë kulturë njerëzore, nuk është e mundur. Duhet të tërhiqemi vazhdimisht nga jeta e ngarkuar e shqisave, edhe për të mundësuar shijimin e plotë të ndijimeve shqisore. Vetëm një shkallë e caktuar e përmbytjes nga objektet materiale të ndijesave bën që edhe jeta shqisore të baraspeshohet, pa përmendur që ajo i lejon shpirtit njerëzor të hapet drejt jetës shpirtërore.

Një nga këto praktika kufizuese është agjërimi, që Islami e urdhëron si detyrim për muajin e Ramazanit dhe e këshillon për periudha të tjera të vitit.

Siç tregon Kur'an-i i shenjtë, ai është një praktikë që ekziston në fetë më të lashta dhe Islami s'bëri tjetër, veçse e ripërtëriu dhe e institucionalizoi në formën e agjërit, në muajin e Ramazanit. Agjërimi gjatë këtij muaji ka shumë avantazhe dhe karakteristika, shoqërore e të jashtme, që janë diskutuar shpesh dhe rëndësia e të cilave në të vërtetë është ekzagjeruar në kontekste të caktuara, sipas të cilave virtyti parësor i agjërit reduktohet në bamirësi për të varfërit. Sigurisht, ky element bamirësie ekziston, por si çdo bamirësi, merr kuptim shpirtëror vetëm kur i drejtohet Zotit.

Dhe, tek agjërimi është bindja ndaj vullnetit

të Zotit për të patur si frut bamirësinë ndaj të varfërve e nevojtarëve dhe një pjesëmarrje e vërtetë në urinë dhe etjen e tyre.

Por aspekti më i vështirë i agjërit është tehu i shpatës së vetëpërmbytjes së drejtpërdrejtë kundër egos epshore, *el-nefs ul-ammareh* të përmendur në Kur'anin famëlartë.

Nëpërmjet agjërit, prirjet rebele të egos epshore qetësohen dalëngadalë, nga një nënshtrim sistematik i këtyre prirjeve ndaj vullnetit të Zotit, duke qenë se në çdo çast urie shpirti i myslimanit kujton që, nëse u largohet pasioneve të egos epshore, kjo është për t'iu bindur urdhrit të Zotit.

Ja përse agjërimi nuk përfshin vetëm të përmbyturit nga ushqimi, por edhe nga çdo formë e luksit dhe e pasionit epshor. Si rezultat i këtij kufizimi sistematik, shpirti njerëzor e kupton se është i pavarur nga mjedisi i afërt natyror dhe ndërgjegjësohet që ndodhet në këtë botë, por nuk i përket asaj.

Një agjëruar fiton shumë shpejt vetëdijen se në këtë botë është vizitor dhe se është krijuar si qenie e destinuar te një synim që ndodhet përtej kësaj ekzistence materiale.

Bota që e rrethon e humbet në njëfarë mënyrë materialitetin e saj dhe merr një pamje zbrazëtie dhe tejdukshmërie që, në rastin e myslimanit soditës, shpie

drejtpërsëdrejti në një soditje të Zotit në krijimin e Tij.

Natyra e privuar dhe e zbratur nga gjërat kompensohet, nga ana tjetër, me shfaqjen e po këtyre si dhurata të Zotit. Gjatë periudhës së agjërimit, ushqimi dhe pijet, që merren për të mirëqena gjatë tërë vitit, shfaqen si dhunti qiellore (*ni'met*) dhe fitojnë domethënie shpirtërore të një natyre të shenjtë.

Po ashtu, agjërimi është veshje me mburojën e pastërtisë kundër pasioneve të dynjasë. Ai do të thotë që trupi të përfshihet edhe "fizikisht" në pastërtinë e vdekjes, e cila natyrisht shoqërohet me lindjen shpirtërore.

Gjatë agjërimit, njeriu kujton faktin se ka zgjedhur t'i afrohet Zotit e t'i largohet botës së pasioneve. Ndaj dhe Profeti i shenjtë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e donte shumë agjërimin. Ai ishte një element themelor i asaj "varfërie të përshpirtshme" (*fekr*), për të cilën ai thoshte: *el-fekr' fakhr'* ("varfëria e përshpirtshme është krenaria ime").

Kjo vdekje nga pasionet e kullon shpirtin njerëzor nga uji i ndotur i mbetjeve të tija negative psikike. Individidi, dhe përmes tij e tërë bashkësia islame, rinovohet nga ky rit, që i kujton detyrat dhe objektivat morale e shpirtërore. Prandaj, ardhja e muajit të Ramazanit pritet me hare. Gjatë tij, dyert e qiellit janë të hapura për besimtarët dhe mëshira e Zotit zbret mbi ata që e kërkojnë.

Plotësimi i agjërimit të Ramazanit nënkupton kryerjen e rigjallërimit dhe rinovimit që e përgatit myslimanin për të përballur një tjetër vit me vendosmërinë e të jetuarit dhe të vepruarit sipas vullnetit të Zotit.

Agjërimi gjithashtu i dhuron shpirtit njerëzor një kundërmim, aroma e të cilit mund të ndijohet edhe për një kohë të gjatë pas mbarimit të tij.

Ai i ofron shpirtit një burim energjie nga e cila ai ushqehet gjatë tërë vitit. Falë kësaj, muaji i shenjtë është quajtur "i bekuari" (*mubarek*), ai në të cilin begatia ose *berekeh* e Zotit vërshon mbi bashkësinë islame dhe ripërtërin burimet e saja më të thella të jetës.

Sejjid Husein Nasr





Urdhërimi në të mira & ndalimi nga të këqijat

Këto janë prej detyrave fetare. Me anë të tyre ndreqet individi dhe shoqëria, si dhe zhduket degjenerimi dhe shfarosen të këqijat.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: *"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin, (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat."*

Dhe: **"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit."**

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Nëse ymeti im e lë urdhërimin në të mira dhe ndalimin nga të këqijat, atëherë le të presin ndëshkimin prej Allahut."

Transmetohet nga Imam Rizai (paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: "Urdhëroni në të mira dhe ndaloni nga të këqijat.

Kur të këqijtë t'ju udhëheqin, atëherë as të mirëve nuk do t'u përgjigjet lutja e tyre."

Imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Vërtet, urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat është rruga e të dërguarve dhe metoda e reformatoreve. Është detyrë mbi të cilën ngrihen detyrat e tjera. Me anë të saj ruhet feja, lejohen fitimet, hiqet padrejtësia, gjallërohet jeta në tokë, pastrohet prej armiqve, si dhe, ndreqen çështjet."

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Sido që të jetë gjendja juaj, kur të prishen gratë tuaja dhe të devijojnë të rinjtë tuaj, a nuk do të urdhëroni ju në të mira e të ndaloni nga të këqijat? Atij i thanë: A do të ndodhë kjo o i Dërguari i Allahut?! Ai u tha: Po. Edhe më keq. Si do të jetë gjendja juaj kur të urdhëroni në të këqija dhe të ndaloni nga e mira?!



Atij i thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguari i Allahut?! Ai u tha: Po. Edhe më keq. Sido jetë gjendja juaj kur ta shihni të mirën të keqe dhe të keqen të mirë?”

Dialogu i urdhërimit në të mira dhe i ndalimit nga të këqijat

Babai im e filloi bisedën me leximin e ajetit të Kur'anit: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** Pastaj tha: O biri im! Është detyra jote që të urdhërosh në të mira dhe të ndalosh nga të këqijat.

Për çfarë të urdhëroj dhe nga çfarë të ndaloj?

Urdhëro në ato që e di që janë të mira dhe ndalo nga ato që i di se janë të këqija.

E çfarë më duhet mua me njerëzit? Çfarë lidhje kanë me mua të këqijat që veprojnë të tjerët që t'i ndaloj ata nga kryerja e tyre? Pastaj, përse të ndërhyj në çështjet e të tjerëve, që

t'i urdhëroj ata e t'i ndaloj përderisa unë vetë nuk bëj të këqija? Kjo më mjafton.

Ki kujdes nga kjo thënie o biri im. Mos e përsërit më këtë që the, sepse urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat janë dy vaxhibe kifai (obligime të mjaftueshme). Nëse askush nuk urdhëron në të mira, pra as unë e as ti, e askush tjetër, ne do të bënim mëkat të

gjithë dhe do të përballeshim me zemërimin e Allahut të Madhëruar dhe me ndëshkimin e Tij.

A nuk e ke lexuar thënien e Allahut: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”**

A nuk e ke lexuar thënien e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i cili ka thënë: “Ymeti im do të vazhdojë të jetë në mirësi përderisa urdhërojnë për të mira dhe ndalojnë nga të këqijat dhe bashkëpunojnë me mirësi. Nëse nuk veprojnë kështu, atyre do t'u hiqen të mirat, do të sundojnë njëri-tjetrin dhe ata nuk do të kenë përkrahës as në tokë e as në qiell.”.

A nuk e ke lexuar thënien e Imam Bakirit (paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: “Vërtet, urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat është rruga e të dërguarve dhe metoda e reformatorëve. Është detyrë mbi të cilën ngrihen detyrat e tjera. Me anë

të saj ruhet feja, lejohen fitimet, hiqet padrejtësia, gjallërohet jeta në tokë dhe pastrohet prej armiqve.” Po ashtu, ai ka thënë: “Të urdhëruarit në të mira dhe të ndaluarit nga të këqijat janë prej moraleve të Allahut. Allahu do ta ndihmojë atë që përpiket që këto të triumfojnë. Nëse njeriu i nënvlerëson, Allahu do ta poshtërojë.”

A nuk e ke dëgjuar thënien e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i cili ka thënë: “Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për kopetë tuaja.”

-Po, i kam dëgjuar.

Atëherë ti je përgjegjës për ata që ke në përgjegjësi. Për përgjegjësin ka detyra dhe të drejta dhe përgjigjësia është e rëndë.

A mund të thuash pas kësaj: përse duhet të ndërhyj në punët e të tjerëve? Ta dish o biri im se kur urdhëron në të mira dhe ndalon nga të këqijat nuk do të thotë të ndërhysh në ato që nuk të interesojnë. Por, kjo është detyra jote. Po po, është detyra jote, sepse Ai që e ka bërë detyrë për ty namazin, agjërimin, haxhin, zekatin, një të pestën (*khums*), Ai e ka bërë detyrë për ty edhe urdhërimin në të mira dhe ndalimin nga të këqijat. Por unë nuk jam dijetar i fesë që të të urdhëroj në të mira dhe të të ndaloj nga të këqijat. Kush të tha ty se të urdhëruarit për të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja

janë detyrë vetëm e dijetarëve të fesë? Kjo vepër është detyrë edhe e jotja, edhe e imja, e studentit, e mësuesit, e tregtarit, e punëtorit, e zyrtarit, e prodhuesit, e ushtarakut, e udhëheqësit, e të pasurit, e të varfërit, e femrës, e mashkullit. Të urdhëruarit në të mira dhe të ndaluarit nga e keqja është detyrë për të gjithë, nëse arrihen kriteret e mëposhtme:

- 1- Të ketë një përqindje dobie prej të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja edhe për persona të tjerë. Për shembull,



kur një i tretë dëgjon dhe heq dorë nga të këqijat. Kështu do të gjendet pakësimi harameve.

- 2- Të mos ketë arsye njeriu në veprimin e të këqijave dhe në lënien e të mirave. Është detyra jote që ta udhëzosh se çfarë duhet të bëjë dhe është detyra jote sqarimi i rregullave të fesë.
- 3- Të mos kihet frikë nga urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat për të mos dëmtuar veten, familjen, pasurinë dhe myslimanët e tjerë.

Abdul Takij el Hakijm

Të njihemi me suret e Kur'anit

26

Shuara

Mekase

227 ajete

1297 fjalë

5522 shkronja

Emërtimi: Poetët.

Shkaku i emërimit: Nga ajeti 224 e në vazhdim të kësaj sureje bëhet fjalë për poetët përgojues, të papërgjegjshëm dhe përgëzohen poetët besimtarë.

Emra të tjerë: Xhamiah, Ta, Sin, Mim.

Përmbajtja e sures

- Madhështia e pozitës së Kur'anit dhe qetësimi i Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) kundër përgojimeve të politeistëve.
- Disa nga shenjat e monoteizmit dhe të cilësive të Zotit.
- Pjesë nga e kaluara e 7 profetëve të mëdhenj dhe përballja me kundërshtimet e popujve të tyre: Musai (paqja qoftë mbi të!) me Faraonin, Ibrahim (paqja qoftë mbi të!), Nuhu (paqja qoftë mbi të!), Hudi (paqja qoftë mbi të!), Salihu (paqja qoftë mbi të!), Luti (paqja qoftë mbi të!) dhe Shuajibi (paqja qoftë mbi të!).
- Logjika e dobët dhe fanatizmi i përhershëm i politeistëve ndaj të dërguarëve të Zotit dhe ngjashmëria me kohën e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!).
- Ndëshkimi i dhimbshëm i atyre popujve dhe mënxyrat e llahtarshme që përjetuan ata.
- Islami, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) dhe madhështia e Kur'anit, urdhëresat për mënyrën e ftesës dhe trajtimi i besimtarëve.
- Dhënia e s'hariqit për besimtarët e singertë dhe kërcënimi i ashpër ndaj shkelësve.
- Qortimi i poetëve që flisnin fjalë të kota dhe që nuk kishin qëllime konstruktive dhe përgëzimi i poetëve besimtarë e të mençur dhe përdorimi i poezisë për forcimin e besimit.

Renditja e sures

Sipas renditjes së tubimit, është surja e 26-të; sipas zbritjes është surja e 46-të e ka zbritur pas sures "Vakia" dhe para sures "Nemi".

Historitë e sures: Musa (paqja qoftë mbi të!): ajetet 10-66; Ibrahim (paqja qoftë mbi të!): ajetet 69-104; Nuh (paqja qoftë mbi të!): ajetet 105-121; Hud (paqja qoftë mbi të!): ajetet 123-139; Salih (paqja qoftë mbi të!): ajetet 141-158; Lut (paqja qoftë mbi të!): ajetet 167-174; Shuajb (paqja qoftë mbi të!): ajetet 176-189.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

طَسَمَ ۝١ تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ۝٢ لَعَلَّكَ بَدِيعٌ نَفْسِكَ
 أَلَّا يَكُونُوا مُؤْمِنِينَ ۝٣ إِنْ نَشَأْ نُزِّلْ عَلَيْهِمْ مِنَ السَّمَاءِ آيَةً فَظَلَّتْ
 أَعْنَاقُهُمْ لَهَا خَاضِعِينَ ۝٤ وَمَا يَأْتِيهِمْ مِنْ ذِكْرٍ مِنَ الرَّحْمَنِ مُحَدَّثٍ
 إِلَّا كَانُوا عَنْهُ مُعْرِضِينَ ۝٥ فَقَدْ كَذَّبُوا فَسَيَأْتِيهِمْ أَنْبَاءُ مَا كَانُوا
 بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ۝٦ أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الْأَرْضِ كَمْ أَنْبَنَّا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ
 كَرِيمٍ ۝٧ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً وَمَا كَانَ أَكْثَرُهُمْ مُؤْمِنِينَ ۝٨ وَإِنَّ
 رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ۝٩

Fillimi dhe fundi

Fillimi: "Ta, Sin, Mim. Këto janë ajete të Librit (Kur'anit) të qartë."

Fundi: "...E ata që bënë keq do ta kuptojnë se ç'përfundim u vjen (ç'dënim të ashpër ose ç'vend do të kenë në Xhehenem)."

Mirësia e sures: Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "Ai që e lexon (a e këndon) suren "Shuara", do të përfitojë dhjetë të mira për çdo person që i ka pranuar apo përgënjeshtuar profetët Nuh (paqja qoftë mbi të!), Hud (paqja qoftë mbi të!), Ibrahim (paqja qoftë mbi të!), Shuajb (paqja qoftë mbi të!), Salih (paqja qoftë mbi të!) dhe sa numri i të gjithë njerëzve që e kanë përgënjeshtuar Isanë (paqja qoftë mbi të!) dhe e kanë pranuar Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)."

R a m a z a n i

Stacioni i pastrimit dhe i shërimit të zemrave

kudo që
ndodhen të
furnizohen më të mirat
e këtij muaji të begatë. Muaji
i Ramazanit është stacion
shpirtëror dhe thesar i pashterur.
Është muaji i veprave dhe i
aktiviteteve kulturore dhe njerëzore.
Me një fjalë, themi se Ramazani
është shkollë e madhe për njeriun.

Me qëllim që ky muaj mos të na ikë
pa përfutur prej tij, duhet ta shfrytëzojmë
me sa të mundemi me të gjitha fuqitë
tona që të furnizohemi me mirësi dhe
veçanërisht, me ushqimin dhe veshjen
më të mirë që është devotshmëria.

Si ta presim muajin e Ramazanit?

Muaji i Ramazanit, muaji i mirësive dhe
i begative. Njerëzit e presin këtë muaj
sipas shkallës së besimit të tyre dhe sasisë
së njohjes që kanë rreth mirësive të këtij
muaji të begatë. Disa e presin këtë muaj
që me fillimin e muajit Rexheb, disa që
nga fillimi i muajit Sha'ban, disa që prej
mesit të muajit Sha'ban dhe disa të tjerë
vetëm kur hyn Ramazani dhe as që e
kanë mendjen se po vjen Ramazani.

Allahu ka caktuar për robtë e Tij stacione
për furnizimin dhe pajisjen me njohje dhe
besim. Këto stacione shpirtërore ndikojnë
së tepërmi në heqjen e pengesave

Sapo vjen muaji i Ramazanit, në
zemrat e besimtarëve shtohet
dashuria dhe bindja sepse
Ramazani është pranvera e
zemrave, ringjallësi i shpirtërave,
prurësi i mirësive dhe mjeti i afrimit tek
Allahu i Madhëruar. Muaji i Ramazanit
është shkollë në të cilën edukohen zemrat
tona për të kuptuar të vërtetat dhe për
të përvetësuar njohuritë. Ai është urtësia e
shërimit të problemeve. Ai është muaji në
të cilin Allahu hap dyert e bujarisë dhe të
begative të Tij për robtë e Vet, që ata të
furnizohen prej detit të pafund të bujarisë
dhe begatisë së Tij.

Ai është muaji në të cilin lidhen dajjtë dhe
mbyllen dyert e Xhehenemit. Ai është
muaji i kthimit tek Allahu. Është muaji i
pendimit dhe i faljes.


Prandaj, është detyrë e besimtarëve

dhe të perdeve ndarëse mes robit dhe Krijuesit të Madhëruar. Muaji i Ramazanit është një prej atyre stacioneve të Allahut, ku vetë Allahu ka ftuar që të përfitohet në të dhe ky fitim është falas, pa shpenzime. Kjo është mirësi dhe mëshirë e Allahut për robtë e Vet, megjithë zemërgurtësinë, mosbindjen dhe largimin e tyre prej burimit absolut të mirësisë e të bujarisë. Në këtë muaj Krijuesi ynë ka shtruar për ne sofrën e mikpritjes. Ky është muaji i pendimit të pakthyesëm në gjynahe. Në këtë muaj të begatë jemi të ftuar në mikpritjen e Allahut. Lum ai që e pranon ftesën dhe respekton rregullat e kësaj mikpritjeje. Në këtë muaj punët shpërblehen më shumë se në muajt e tjerë, veçanërisht leximi i Kur'anit. Kushdo që lexon një sure apo edhe një ajet të vetëm është njësoj sikur ta ketë lexuar të gjithë Kur'anin. Kush rri gjatë në ruku dhe suxhud (seshde) në këtë muaj, Allahu do t'ia largojë të këqijat që ka bërë. Kush fal sa më shumë namaz, do të ngrihet në shkallë të larta sepse namazi është miraxhi i besimtarit. Mikëpritja e Allahut ka dimensione të ndryshme. Vërtet, Allahu është më i Mëshirshmi i mëshiruesve, Ai ka emrat më të bukur dhe sofra e Tij nuk është e kufizuar me një lloj të vetëm të mirësive të Tij, por përmban të gjitha mirësitë duke filluar që nga ato materiale e deri tek ato shpirtërore. Duhet të dimë se kur hyn ky muaj, mirësitë zbresin si shiu për njerëzit.

Në muajin e Ramazanit, krahas adhurimit të agjërimit duhet të kryejmë edhe disa veprimtari të tjera si:

1- Të interesohemi për çështjet e besimit me qëllim që ta përhapim atë në mesin e shoqërisë. S'ka dyshim se përhapja e bazave të besimit në shoqëri, bën që dukuritë negative të zhduken. Kjo arrihet kur njerëzit kthehen tek Krijuesi i tyre, i Cili u ka dhuruar jetën dhe ka caktuar kufijtë se si të jetojmë në këtë jetë dhe na ka caktuar se kush është e mira dhe kush është e keqja. Për ta arritur këtë qëllim duhen përdorur të gjitha mundësitë që ofrojnë përcjelljen e mesazheve të Islamit për mbarë njerëzinë, siç janë botimet e librave, botimet e artikujve nëpër gazeta e revista, prezantimi i programeve nëpër radio dhe televizione, si dhe përdorimi i internetit. Pra, është detyrë e dijetarëve që shoqërinë ta shpëtojë prej kthetrave të mërzitjes dhe sëmundjeve të ndryshme shpirtërore që janë të përhapura në shoqërinë tonë. Të mbjellin besimin e pastër në zemrat dhe shpirtërat e të rinjve dhe të rejave dhe jo të mbjellin farën e urrejtjes e të armiqësisë.

2- Domosdoshmëria e heqjes së pengesave dhe e perdeve mes njerëzve dhe Kur'anit të shenjtë. Është një fatkeqësi e madhe në këto ditë ku Kur'ani është kufizuar tek njerëzit vetëm në raste ceremonish dhe përkujtimeve dhe





ndoshta kanë harruar që Kur'ani është Libri i jetës, i cili përmban dhe sqaron çdo gjë. Është detyrë e myslimanëve të kthehen tek Kur'ani dhe të studiojnë e të logjikojnë rreth ajeteve të Librit epokëbërës dhe të mos e mbajnë varur nëpër muret e shtëpisë apo para xhamave të makinave por ta varin në zemrat dhe shpirtërat e tyre, sepse Kur'ani është dritë, mëshirë, shërim dhe udhëzues në atë që është më e mira dhe më e përkryera. Çdo fjalë dhe çdo ajet i Kur'anit ka për qëllim lumturinë, sigurinë dhe shpëtimin e besimtarëve.

3- Domosdoshmëria e forcimit të marrëdhënieve shoqërore në këtë muaj. Kjo të kryhet nëpërmjet vizitave dhe ftesave në iftare apo ceremoni të ndryshme fetare. Kjo bën të mundur që të zhduken mendimet e keqja dhe paragjykimet që mund të kenë njerëzit

ndaj njëri-tjetrit. Gjithashtu, nëpërmjet vizitave dhe tubimeve njerëzit njihen më mirë me gjendjet e tyre dhe përpiqen që brenda mundësive të kontribojnë në zgjidhjen e problemeve të atyre që janë në nevojë.


4- Edukimi i vetvetes me edukatën dhe moralin e Islamit. Duke menduar thellë rreth këtij adhurimi dhe për dobitë e shumta morale dhe edukative që përmban muaji i Ramazanit, është detyrë që ta shfrytëzojmë këtë kohë dhe të funizohemi me ushqimin më të mirë dhe me veshjen më të bukur që është devotshmëria. Nëse do ta arrijmë këtë gjë, kjo do të thotë se kemi zbatuar thënien e Allahut në Kur'anin e shenjtë, i cili në suren "Bekare", ajeti 186 na thotë se boshti kryesor i Ramazanit dhe i agjërimit është devotshmëria.

5- Të shtojmë sa më shumë njohjen dhe

dashurinë për Profetin tonë të dashur, hazreti Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), për familjen e tij të pastër e të nderuar dhe për të gjithë ata që sakrifkuan për përhapjen e fesë dhe të fjalës së Allahut, Kur'anin e shenjtë. Kjo arrihet duke lexuar jetëshkrimet e tyre të cilët janë të mbushura me mësim të çmuara për çdo brez.

Mirësia e
Muaji

Kur'anit
i



Ramazinit muaji i zbritjes është pranvera e tij. është një mirësi e madhe e pastruesi dhe shëruesi i zemrave tona. Ai na lajmëron për të vërtetat e shkuara të sotme dhe të ardhshme. Ai që e merr atë për prijs, e çon në Xhenet dhe kush mendon se ai është prijs për Kur'anin, ai është i humbur në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Duhet që në këtë muaj të begatë ta lexojmë sa më shumë Kur'anin e shenjtë dhe të përfitojmë sa më shumë prej tij. Kur'ani është mesazhi i Allahut për ne. Ai është litari i fortë i Tij dhe na urdhëron që të kapemi pas tij dhe të mos përçahemi. **"Kapuni të gjithë pas litarit të Allahut e mos u përçani"**. (Sure "Ali Imran", ajeti 103) Allahu i Madhëruar e mbarëson, e ruan dhe e lumturon lexuesin e Kur'anit si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: **"Allahu nuk e dënon atë zemër që e ka kuptuar Kur'anin."** Dhe: **"Nëse dëshironi jetën e të lumturve, vdekjen e martirëve, shpëtim në ditën e vështirë, hijëzim në ditën e nxehtë dhe udhëzim në ditën e humbjes, mësojeni Kur'anin sepse ai është fjala e Gjithëmëshirmit (Rahmanit), mbrojtje prej shejtanit dhe anues kah të mirat në ditën e llogarisë."** Dhe: **"Cilido prind që ia mëson fëmijës së vet Kur'anin, Allahu do t'u veshë atyre kurorën e mbretit dhe do t'i veshë me rroba që njerëzit nuk i kanë parë asnjëherë."** Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Mësojeni Kur'anin, sepse ai është biseda më e mirë. Mendoni në të, sepse ai është pranvera e zemrave. Kërkoni shërim prej dritës së tij, sepse ai është shërues i gjokseve. Lexojeni sa më bukur, sepse ai është rrëfimi më i përkryer."**

Vullnet MERJA

Emrat e bukur të Zotit



El Musavvir – Formëdhënësi

“Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi, Shpikësi i pashembullt i çdo gjëje, Formësuesi i gjithçkaje.” (59:24)

Allahu i dha formën krijesave të Tij dhe i bëri ato të shumta dhe të ndryshme. Ai i dha secilës formë, që është unike dhe e dallueshme nga të tjerat. **“Ne ju krijuam ju dhe pastaj ju dhamë formë.”** (7:11) **“Ai është i Cili ju formëson në mitra ashtu siç Ai dëshiron.”** (3:6) Allahu e bëri çdo gjë në formën më të mirë; e përshtatur deri në fund për atë që është krijuar. **“Dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të mirë dhe ju pajisi me të mira.”** (40:64) Përveç bukurisë dhe madhështisë së krijimit, Ai e pajisi njeriun me prirje, aftësi dhe cilësi të veçanta dhe me një epërsi të veçantë që e ngre atë në formën e tij më të mirë, në pozitën e mëkëmbësit të Allahut në Tokë. **“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të mirë.”** (95:4) Vetëm një njeri vetëmashtrues e injoron gjithë atë. **“O ti njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është Bujar e i Urtë? I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi, të formësoi në formën që Ai dëshiroi?!”** (82:6-8)

“O ti njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është Bujar e i Urtë? I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi, të formësoi në formën që Ai dëshiroi?!” (82:6-8)

Bota është mbërthyer nga e keqja, kështu që njeriu duhet të mësojë të jetë i mirë.

Samira Fajad Havaldeh

Dashuria për nënën

Pas 21 vitesh martesë, arrita një dashuri të çiltër. Para disa kohësh, fillova të kaloja kohën me një grua të ve prej 19 vitesh. Gruaja ime ma parapriu me fjalët e saja, duke thënë: E di shumë mirë se sa e doni atë. Gruaja për të cilën më këshillonte shoqja ime të kaloja çaste me të, ishte nëna ime, e cila kishte mbetur e ve para 19 vitesh. Punët e shumta si dhe 3 fëmijët kishin bërë që nënën time ta vizitoja shumë rrallë. Një ditë prej ditësh, gjeta kohën që ta ftoja nënën time për darkë. Mora telefonin dhe i telefonova. Ishte bërë vonë dhe nëna u bë merak kur ma dëgjoi zërin. Nuk e kishte zakon të fliste me dikë në orë të vona dhe më pyeti: Si je biri im? - Mirë jam nënë - iu përgjigja. Të telefonova për të kaluar disa çaste me ju. Më pyeti: Vetëm ne të dy? U mendua pak dhe më tha: Më pëlqen propozimi yt... Ditën e enjte, pasi mbarova orarin e punës, u nisa për në shtëpinë ku banonte nëna ime. Ndihesha paksa i shqetësuar...Kur arrita në shtëpinë e nënës, vërejta se edhe ajo ishte paksa e merakosur. Ajo ishte duke pritur te dera e shtëpisë.



Ishte veshur bukur dhe m'u duk se kishte veshur fustanin e fundit që ia kishte blerë babai im pak para se të vdiste. Duke buzëqeshur si një engjëll, më tha: Biri im, të gjithëve u kam thënë se sonte do të dal me djalin tim dhe që të gjithë janë gëzuar, prandaj të gjithë presin me padurim kthimin tim për t'ju sqaruar hollësitë e këtij takimi.

Shkuam në një restorant jo të zakonshëm, por i bukur dhe i qetë. Nëna u mbështet në krahun tim dhe dukej sikur të ishte një zonjë. Pasi u ulëm, fillova ta lexoja listën e gjellëve, edhe pse nëna nuk ishte në gjendje të lexonte, përveç shkronjave

të mëdha. Ndërsa po lexoja listën e ushqimeve, nëna më shikonte me një buzëqeshje të gjerë, me dy buzët e saja të çara, më ndërhyri, duke thënë: "Kur ishe i vogël, unë isha ajo që lexoja për ju", ndërsa tani ka ardhur koha të ta kthej këtë borxh dhe ja, unë po lexoj sot për ty. Çlodhu dhe pusho, nëna ime - i thashë. Gjatë tërë mbrëmjes biseduam dhe nuk kishte asgjë të rëndomtë, me përjashtim të nostalgjive dhe përditshmërisë sonë. Qëndruam aq shumë, sa ishte bërë shumë vonë.



Pasi u kthyem dhe arritëm te dera e shtëpisë, nëna m'u drejtua me këto fjalë: Kam dëshirë që të dalim së bashku përsëri, mirëpo me kusht që unë të paguaj. Ia putha dorën dhe i thashë lamtumirë. Pas disa ditësh, më erdhi lajmi se nëna kishte ndërruar jetë. Kishte vdekur nga ataku në zemër. E tërë kjo ndodhi për një kohë shumë të shkurtër e unë nuk munda të bëja asgjë për të. Kaluan ca ditë dhe nga posta më erdhi një letër e dërguar nga restoranti, në të cilin kishim qenë unë dhe nëna ime. Në të kishin qenë disa fjali të shkruara nga dora e nënës sime: "Kam paguar faturën para kohe, duke e ditur se nuk do të kem rastin të takohem me ty përsëri. Me rëndësi është se bëra pagesën për dy persona, për ju dhe gruan tuaj. Ju nuk mund ta përshkruani vlerën e asaj nate së

bashku. Të dua shumë biri im". Në këtë moment, arrita të kuptoj domethënien e fjalës "Dashuri" apo "Të Dua".

Nuk mund ta kuptosh domethënien madhështore të kësaj fjale, derisa nga dashuria juaj të mos vjelë mirësi dhe bukuri edhe pala tjetër, ashtu siç bëri nëna ime. Asgjë nuk ka vlerë më shumë sesa prindërit, e në veçanti, nëna. Dhurojani kohën të cilën ata e meritojnë... Duhet ditur se ky është detyrim i Allahut dhe i prindërve, prandaj këto gjëra nuk shtyhen.

Shpresojmë se porosia dhe mesazhi i kësaj ngjarjeje do t'ju arrijë edhe juve të cilët i keni ende prindërit gjallë.

Walid. I. S. Sharaiyra



A e doni Lumturinë? Lexoni këshillat e Lukmanit

*Falënderimet janë për Allahun, Sunduesin e botëve.
Paqja dhe bekimi i Tij qoftë mbi profetin Muhamed dhe
mbi familjen e tij të pastër e të ndritur!*

Sa nevojë ka shoqëria e sotme për këshillë. Vallë, a nuk është këshilla veçse lajmërim për një jetë të lumtur dhe për ecjen në rrugën e drejtë?

Lukmani ishte këshillues i madh. E kjo sepse Allahu i Madhëruar na e përmend këshillën e tij (Lukmanit) në Kur'anin fisnik, edhe pse kanë kaluar me dhjetëra shekuj nga këshillat e Lukmanit të urtë, ata përsëri kanë dhe do të kenë ndikimin reformues si për individin ashtu edhe për shoqëritë. Sa nevojë kanë njerëzit në përgjithësi, e ne myslimanët në veçanti, të cilët neglizhojmë ndaj Kur'anit dhe traditës së pastër profetike, për këto këshilla të çmuara! Është detyrë e jona që këto këshilla të lexohen e prej tyre të nxirren mësim.

Kur'ani fisnik thotë: **"Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë):**

"Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim".

Në këtë ajet ka argument të qartë se urtësia është mirësi prej mirësive të mëdhaja të Allahut të cilën ia jep njerëzve më të mirë të Tij dhe me anë të këshillës e ndan të kotën nga e vërteta. Allahu i Madhëruar e lavdëron urtësinë duke thënë në Kur'an: **"Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. ("Bekare", 269)**

Disa njerëz i thanë Lukmanit: "A nuk je bari delesh së bashku me ne? Nga të erdhi urtësia? Ai iu përgjigj: "Më erdhi duke përcjellë amanetin, duke thënë të vërtetën dhe duke heshtur për ato që nuk më interesojnë."

E kanë pyetur Lukmanin: "Kush është



mendimtari? Është përgjigjur: “Ai që nuk vepron fshehtas ato vepra, me anë të të cilave, turpërohet po t’i veprojë haptazi.”

Në Kur’ani fisnik, në suren “Lukman”, ajetet 16 - 19, thuhet: **“O biri im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.”** O djali im, kryejë namazin, urdhëroje të mirën, pengojë të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve! Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”

Mësime të përkryera nga këto këshilla të ajeteve

- 1- Çfarëdo pune, e mirë apo e keqe, qoftë sa kokrra e sinapit, njeriu do të shpërblehet dhe do të ndëshkohet.
- 2- Falja e namazit.

3- Urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat

4- Durimi ndaj fatkeqësive dhe problemeve me të cilat përballet njeriu në jetën e tij të përditshme.

5- Mosshfaqja e mendjemadhësisë ndaj njerëzve të tjerë

6- Të ecurit me modesti.

7- Përdorimi i të mesmes në çdo çështje të jetës, pra as të mos tepruhet e as të mos neglizhohet.

8- Ulja e zërit kur bisedohet me të tjerët. Sepse zëri i lartë është i njëjtë me zërin e gomarit kur pëllet. A ka këshilla më të përkryera se këto? A mundet që një ditë këto këshilla të bëhen të pavlefshme? Jo. Kurrë nuk mund të ndodhë.

Lukmani i ka thënë djalit të tij se dynjaja është det i thellë. Në këtë dynja janë shkatërruar shumë njerëz. Prandaj, anija jote në këtë jetë të jetë besimi në Allahun Një e të Vetëm e të Pashoq. Vel i kësaj anijeje të jetë mbështetja tek Allahu. Furnizimi yt në këtë anije të jetë devotshmëria ndaj Allahut. Nëse shpëton, është prej mëshirës së Allahut. E nëse mbytesh, e ke nga gjynahet e tua.

O biri im, që n g a dita që ke ardhur në këtë botë e ke lënë pas atë dhe ke pritur Ahiretin. Jeta drejt së cilës po ecën është më afër se jeta në të cilën po jeton e po largohesh prej saj.

O biri im, ulu me dijetarët... Mos debato me to se do të të ndalojnë. Merr nga dynjaja elokuencën dhe mos e refuzo, sepse do të



mësosh se vetja jote është në dorën e tjetërkujt dhe se gjumi është si vdekja, po ashtu edhe zgjimi është si Ringjallja pas vdekjes.

O biri im, sikur të të qëllojë i urti e të të dëmtojë, është më mirë se sa të të ngjyrosë i padituri me bojë të mirë.

O biri im, m o s i a

bëhesh nevojtar tek njerëzit. Agjëro që të largosh epshet dhe mos ndalo prej namazit, sepse namazi është më i dashur tek Allahu sesa agjërimi.

O biri im, kije frikë Allahun, ki shpresë tek Ai. Sikur ta nxjerrin zemrën e besimtarit e ta hapin, do të shohin në të dy drita: dritën e frikës dhe dritën e shpresës. Sikur t'i peshojmë këto të dyja, asnjëra nuk është më e rëndë se tjetra, asnjë grimcë.

O biri im, nëse dyshon tek vdekja, atëherë largoje gjumin nga vetja jote por t'i kurrë nuk mund ta bësh. Nëse dyshon në Ringjallje, largoje nga vetja jote zgjimin. Por ti kurrë nuk mund ta bësh. Nëse mendon për këtë, do ta

shfaq sekretin tënd gruas tënde dhe mos u ul te pragu i derës tënde.

O biri im, merr njëmijë shokë dhe njëmijë janë pak. E mos merr asnjë amik se edhe një është shumë.

O biri im, unë mbarta gurë dhe hekur dhe secila barrë ishte e rëndë. Por nuk kam mbartur gjë më të keqe se fqinji i keq. I kam provuar të gjitha hidhësitë, por nuk kam provuar hidhësi më të madhe se sa varfëria.

O biri im, unë i shërbeva katër mijë të dërguarve në katërmijë vjet dhe prej fjalëve të secilit, nga ata zgjodha tetë. Katër të parat janë: nëse je në namaz, ruaj zemrën tënde; kur të jesh mes njerëzve, ruaj gjuhën

tënde; kur të jesh mes të mirave, ruaj moralin tënd; kur të jesh tek shtëpia e tjetrit, ruaj shikimin tënd. Ndërsa të tjerat janë: Kujto gjithmonë dy gjëra: Krijuesin dhe vdekjen. Harroji përgjithmonë dy gjëra: bamirësinë tënde ndaj të drejtës së tjetrit dhe të bërit keq tjetrit për të drejtën tënde.

O biri im, ai që nuk përmban gjuhën e tij, pendohet. Ai që e shton shtirjen, ofendon. Ai që hyn në vende të këqija, akuzohet. Ai që shoqërohet me të keqin, nuk është i sigurtë. Dhe, ai që shoqërohet me dijetarët, pasurohet.

O biri im, mos e vono pendimin, sepse vdekja vjen papritur.

O biri im, vëre pasurinë tënde në zemër, sepse po të varfërohesh mos u bisedo njerëzve për varfërinë tënde, por kërkoji Allahut prej mirësive të Tij. O biri im, gënjen ai që thotë se e keqja hiqet me të keqe. A nuk e sheh se zjarri nuk shuhet me zjarr, por me ujë. Po ashtu, edhe e keqja, ajo nuk fiket vetëm se me të mirën.

O biri im, mos e fajëso të privuarin. Mos e pengo të mirën, sepse ajo është thesari yt në këtë jetë dhe në jetën Tjetër.

O biri im, kur ke dalë nga barku i nënës tënde, e ke lënë pas dynjanë dhe i je drejtuar Ahiretit. Për çdo ditë, ajo që po të pret bëhet më afër se ajo që po e lë pas. Prandaj, furnizohu për atë jetë që po të pret. Pajisu me devotshmëri, sepse ajo është tregtia më fituese. Po bëre ndonjë gjynah, pendohu shpejt. Kujtoje gjithmonë vdekjen dhe daljen para Krijuesit tënd. Kujto dëshminë e gjymtyrëve të tua ndaj teje dhe punëve të tua. Dije se melekët janë caktuar për ty, prandaj ki turp nga ato dhe nga Zoti yt, i Cili është Dëshmitar për ty. Dëgjoji këshillat dhe zbatoji ato. Ato tek mendimtari janë më të ëmbla se hoji i mjaltit dhe tek

mendjelehti më të vështira se ngjitja e shkallëve për të moshuarin. Mos dëgjo muzikën, sepse ajo të harron Ahiretin. Shoqëro xhenazetë dhe vizitoji varret që të kujtosh vdekjen dhe vështirësitë pas vdekjes, që të jesh i kujdesshëm.

O biri im, mbështetju Allahut prej të keqes së femrave. Dhe ji i kujdesshmëm ndaj atyre që janë të mira.

O biri im, mos u gëzo më padrejtësinë që i bëhet tjetrit, por hidhërohu prej asaj padrejtësie që i ka rënë.

O biri im, padrejtësia është e shumtë në këtë jetë dhe në Ahiret do të jetë fatkeqësi. Nëse mundësia e padrejtësisë të fton që t'i bësh padrejtësi atij që është i pafuqishëm, kujto fuqinë e Allahut mbi ty.

O biri im, mëso prej dijetarëve ato që nuk i di dhe mësojua njerëzve ato që mëson, sepse me këtë do të kujtohesh te Zoti.

O biri im, njeriu më i pasur është ai që është i bindur me atë që ka në dorë. Më i varfëri i njerëzve është ai që shikon ato që kanë të tjerët.

O biri im, përpiqu që dita e sotme të jetë më e mirë se e djeshmja dhe e nesërmja të jetë më e mirë se dita e sotme. Ai që i ka ditët e barabarta është i mashtruar dhe ai që ditën e sotme e ka më të keqe se të djeshmen është i mallkuar.

O biri im, ji i kënaqur me atë që të ka caktuar Allahu, sepse Ai thotë se robi Im më gjynahqar është ai që nuk është i kënaqur me vendimin Tim dhe nuk ka falënderuar mirësitë e Mia dhe nuk ka duruar sprovat e Mia.

O biri im, mos e merr të paditurin si të dërguar... Ji ti i dërguar i vetes tënde!

*Përzgjedhi dhe përktheu:
Vullnet Merja*



Tregues i emrave m y s l i m a n ë

Hidajet (Hidàjet)	Hydajet, Idajet, Jeti	Udhëzim në rrugën e vërtetë të besimit në Allahun
Hifzi (Hifdhij)	Hifzi	Ruajtës i fjalëve në mendje
Hiqmet (Hikmet)	Hiqmet, Met.	Urtësi, punë e vënë në vendin e duhur
Hysen (Husejn)	Hysen, Cen, Hys, Hyso	Bukurosh
Hysni (Husnij)	Hysni	Bukurosh i ëmbël
Naile (Neijleh)	Naile	Dhënëse
Naxhije (Nàxhie)	Naxhie	Shpëtime
Nazmije (Nadhmij'jeh)	Nazmije	Sistemuese e sendeve me vlerë, autore librash
Nebahet (Nebàhet)	Nebàhet	Zgjuarësi e ndritur
Nesibe (Nesijbeh)	Nesibe, Nasibe	E afërme





11 mënyra për ta bërë Ramazanin të veçantë për fëmijët tuaj

1. Mbani takim familjar rreth Ramazanit

Mbani takimin familjar për t'ua shpjeguar se ç'është Ramazani, çfarë bëjnë myslimanët dhe si ndryshon orari i tyre në Ramazan. Gjithashtu, pyetini për propozime se çka dëshiron të bëjë secili gjatë muajit të Ramazanit. Për shembull: A dëshirojnë ata të udhëtojnë diku, të hanë ndonjë ushqim të veçantë?

2. Priteni muajin me balona, flamuj dhe me sende të tjera

Bindni fëmijët të ndihmojnë rreth dekorimit të vendit dhe pyetini për idetë dhe propozimet e tyre që të ndihen të përfshirë në këtë.

3. Tregojuni çdo natë ngjarje nga Ramazani gjatë kohës kur shkojnë në shtrat

Mos u mbështetni vetëm në librin për fëmijë rreth Ramazanit për t'u treguar ngjarje. Përshkruajuni se si ju është dukur ju Ramazani në kohën kur keni qenë fëmijë. Ju gjithashtu, mund të bëni disa

tregime me fëmijën tuaj si personazh kryesor në një aventurë të Ramazanit.

4. Lëri ata të agjërojnë qoftë edhe një çerek të ditës dhe të festojnë.

Fëmijët shpesh duan të agjërojnë ashtu siç i shohin prindërit e tyre dhe motrat e vëllezërit më të mëdhenj. Këtë vit i lejoni ata të agjërojnë për disa orë. Përgatitni një iftar të veçantë për ta, kur ata të prishin agjërimin, me disa ushqime të tyre të preferuara.

5. Bëni vizatime në shtëpi rreth Ramazanit

Arti është mënyrë e mrekullueshme për të mësuar më shumë rreth Ramazanit. Vizatojuni fëmijëve format e ndryshme të hënave dhe tregojuni se cila tregon për fillimin e muajit, cila mesin e muajit dhe cila prej tyre tregon fundin e muajit; bëj një përmbledhje të ushqimeve të tyre më të preferuara për iftar; bëju atyre një vend të veçantë në tavolinën e ngrënies.

6. Ftojini shokët e tyre në një iftar vetëm për fëmijë

Lërimi fëmijët të vijnë me listën e mysafirëve dhe listën e gjellëve. Gjithashtu, lërimi ata të bëjnë diçka për ushqimin. Mund të zgjedhni disa receta të shokëve të fëmijëve ose ata mund të ndihmojnë me përgatitjen e iftarit që nuk duhet të përfshijë përdorimin e sobës apo prerjen me thikë.

7. Thërrisni gjyshërit ose anëtarët e vjetër të xhematit për iftar.

Pasi secili të ketë ngrënë, mbani një mbledhje për tregimin e ngjarjeve ku mysafirët të përshkruajnë se si u është dukur Ramazani kur ata po rriteshin. Si lajmërohej koha e iftarit? Në disa shtete e kanë përdorur daullen. Në vendet e tjera është bërë lajmërimi me gojë. Çfarë ushqimesh kanë ngrënë ata? Çfarë lojërash kanë luajtur ata gjatë Ramazanit?

8. Bëjeni albumin e Ramazanit të këtij viti.

Merrni disa fotografi të secilit gjatë

kohës së syfyrit dhe të iftarit, gjithashtu gjatë kohës sa ishin agjërueshëm dhe pjesët e dekorimeve që janë përdorur, afishet interesante etj. për ta bërë albumin e këtij Ramazani. Çdo fëmijë duhet të sjellë nga tre kujtime që dëshiron t'i përfshijë në të.

9. Krijoni dhe dërgoni kartolina të Ramazanit të bëra vetë

Krijoni kartolina të Ramazanit për vëllezërit, motrat, gjyshërit. Dërgojni kartolinat shpejt se koha kalon!

10. Merrni ata në namazin e Teravive që ta ndiejnë se janë pjesë e xhematit.

Asgjë nuk e mëson shpirtin e xhematit si namazi me xhemat. Merrni fëmijët me vete në xhami për namazin e Teravive gjatë netëve të premte dhe të shtune kur detyrat e shtëpisë nuk janë problem.

11. Përkujtojeni të varfërit.

Gjithashtu, kërkoni prej tyre që t'i japin për bamirësi disa prej ushqimeve të tyre derisa janë atje.



Mësime nga surja “Fatiha”



1- “Bismil-lahi” dhe emri i Zotit janë begati dhe garanci në punë si dhe tregojnë mbështetjen në Zotin Fuqiplotë.

2- “Bismil-lahi” i mbron veprat e njeriut nga “shirku” dhe dredhitë.

3- “Bismil-lahi” d.m.th. Zoti im, unë nuk të kam harruar Ty dhe as Ti mos më harro mua.

4- Ai që e thotë “Bismil-lahin”, veten e ka mbështetur tek fuqia dhe mëshira e pafund e Zotit.

5- Nevoja jonë dhe e gjithësisë për Zotin nuk është vetëm për krijimin tonë, por edhe zhvillimi dhe kultivimi ynë është në duart e Zotit dhe lidhjet e Tij me krijesat janë të përhershme. Për këtë arsye, ne vazhdimisht duhet të jemi falënderues ndaj begatave të Zotit.

6- Jo vetëm në këtë botë, por edhe në Ditën e Gjykimit, shprehja e banorëve të Xhenetit do të jetë “Elhamdu Lil-lahi Rab-bil Alemin”- “Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!”.

7- Zoti, krijesat i edukon bashkë me mëshirën e Tij të pafund, sepse para dhe pas shprehjes “Zot i botëve”, Vetën e paraqet si “Mëshirues” dhe “Mëshirëbërës”. Kjo është me kuptimin që kultivimi ndodhet midis dy mëshirave dhe mësimi e edukimi fillon nga mëshira dhe falja e Zotit dhe përfundon me mëshirën dhe faljen e Tij.

8- Nëse edukatorët dhe mësuesit e shoqërisë dëshirojnë të jenë të suksesshëm në shoqëri, edhe ata duhet të punojnë me dashuri dhe përgjegjësi.

9- Përkrah shpresës në mëshirën e pafund të Zotit, duhet të kemi kujdes edhe ndaj llogarive dhe dënimit në Ditën e Gjykimit.

10- Duke besuar në Ditën e Gjykimit, nuk duhet të frikësohemi që veprat tona të mira do të mbesin pa u shpërblyer.

11- Zoti është në dijeni të çdo veprë tonë, qoftë e mirë apo e keqe dhe Ai do të japë shpërblimin apo dënimin për atë që veprojmë.



12- Megjithëse ne i pranojmë rregullat dhe ligjet e krijimit që sundojnë botën, këto rregulla i cilësojmë si shenjë e dijes dhe e vullnetit të Zotit. Ne dorëzohemi vetëm përballë Zotit dhe nuk jemi robër të natyrës.

13- Nëse në çdo namaz ne themi se jemi robër vetëm të Zotit, atëherë nuk mbetet më vend për mendjemadhësi dhe kryelartësi.

14- Rruga e lumturisë është rruga e drejtë sepse rruga e Zotit është e sigurt dhe e pandryshueshme, gjë që nuk ndodh me rrugët e tjera njerëzore që për çdo ditë pësojnë ndryshime.

15- Distanca më e shkurtër midis dy pikave është vetëm në rrugën e drejtë, e cila është rruga e vetme dhe e pastër nga çdo devijim. Në këtë rrugë njeriu në kohën më të shkurtër arrin në destinacionin e dëshiruar.

16- Për zgjedhjen e rrugës së drejtë ne duhet të kërkojmë ndihmë nga Zoti, sepse ne jemi vazhdimisht të kërcënuar nga devijimi dhe dështimi dhe nëse deri më tani nuk kemi rrëshqitur nga rruga, kjo nuk do të thotë se edhe në vazhdim do të jemi të mbrojtur. Historia dëshmon se shumë njerëz, të gjithë jetën e kanë kaluar në besim dhe lutje, por kur kanë ardhur në pasuri apo pushtet, i kanë harruar të gjitha, madje edhe Zotin.



17- Në zgjedhjen e rrugës së drejtë ne kemi nevojë për shembuj dhe Zoti në ajetin 69 të sures "Nisa" thotë: "**...pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe më të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!**"

18- Çdo gjë që i vjen njeriut nga Zoti është begati dhe mirësi, kurse hidhërimin dhe dënimin e Zotit ne e sjellim vetë me veprat tona.



A janë të rëndësishme pasuria dhe statusi në këtë botë?

Shumica e njerëzve besojnë se jeta në paqe mund të arrihet në këtë botë. Kjo mendësi sugjeron se njeriu mund të gjejë lumturinë e vërtetë dhe të fitojë respekt nga të tjerët nëse bëhet i pasur. Mendësi e njëjtë si kjo besohet se kur të arrihet kjo, do të zgjasë deri në fund të botës. Por, e vërteta qëndron ndryshe. Njeriu kurrë nuk do të mund të arrijë jetën e ëndrrave të veta duke harruar Krijuesin e vet dhe Ditën e Gjykimit. Psikologjia e jobesimtarëve shumë qartë shpjegohet në ajetin: **“Ti më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar. Dhe bëra këtë pasuri të madhe. E bëra edhe me djem që i ka me vete. Dhe Unë i dhashë të gjitha mundësitë. E ai**

lakmon që t’i shtojë edhe më tepër.” (“Mudeth’thir”, 11-15)

Nëse ke shtëpinë më të madhe në botë, a është e mundur që të kënaqesh me komfortin e secilës dhomë në të njëjtën kohë? Gjithashtu, nëse ke garderobë të modës së fundit, sa rroba mund të veshësh gjatë ditës?

Lista do të mund të zgjatej edhe më tej, por fakti më i madh është se njeriu është i destinuar në një kohë të kufizuar të jetës në të cilën mund të shijojë luksin e pasurisë së tij. Njeriu shpejt shkon kah fundi i tij. Sidoqoftë, ai mezi e kupton këtë gjatë jetës së tij dhe mendon se pasuria e tij do t’i sjellë atij lumturi të amshueshme, siç tregon ajeti: **“E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.”** (“Humeze”, 3)

Njeriu është i hipnotizuar me fuqinë e pasurisë së vet dhe kur të përballët me fundin e tij në Ditën e Gjykimit, ai do të përpiqet t'i ikë dënimit duke e falur pasurinë e vet: **"Edhe pse ata shihen ndërmjet njëri-tjetrit (edhe njihen, por ikin prej njëri-tjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet, dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij tek të cilët ai mbështetej. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar! Jo, kurrësi, ajo (para) është Ledh'dha - flaka (emër i Xhehenemit)."** ("Me'arixh", 11-15)

Sidoqoftë, disa njerëz janë të vetëdijshëm se pasuria, fati i mirë janë nën kontrollin e Allahut. Vetëm këta njerëz sinqerisht e kuptojnë se kjo pasuri nuk do t'i shpëtojë ata në Ahiret. Prandaj, ata nuk jepen pas sendeve të vlefshme të kësaj bote. Shfaqja e arrogancës nuk është tipari që pritët prej këtyre njerëzve aq modestë. Duke mos harruar kurrë ekzistencën e Allahut të Plotfuqishëm, i bën ata që të jenë falënderues për çdo gjë që Ai u jep. Si përgjigje për sjellje të tillë, Allahu premton jetë të ndershme dhe të rehatshme për ta. Njerëzit që besojnë Allahun, të qenit shërbëtorë të Allahut, e kanë si qëllimin përfundimtar të jetës së tyre dhe janë të vetëdijshëm se nga gjërat e kësaj bote mund të kenë



përfitim vetëm për një kohë të caktuar dhe se mallrat e kësaj bote janë të pavlefshme në krahasim me bollëkun e premtuar të përhershëm. Pasuria kurrë nuk i bën këta njerëz të jepen pas kësaj bote. Në të kundërtën, ata i bëjnë më falënderues dhe më afër Allahut. Ata punojnë drejtësisht me çdokënd dhe çdo çështje dhe mundohen me çfarë Allahu u ka dhënë, që të fitojnë kënaqësinë e Tij. Më me dëshirë se sa të kënaqen nga pasuria e kësaj bote, ata synojnë t'i arrijnë vlerat kur'anore që priten nga ata, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se statusi dhe lëvdata janë të rëndësishme në prani të Allahut. Profeti Sulejman na jep një shembull për të gjithë njerëzit si një besimtar i ndershëm duke shfaqur tipare të tilla në jetën e tij. Sulejmani qartë e tregon pse e ka ndjekur një pasuri të madhe: **"E ai tha: 'Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Zotit tim, derisa (dielli) u**



fsheh dhe perëndoi.’” (“Sad”, 32)

Dështimi, që të kuptohet pse mallrat e kësaj bote janë krijuar në këtë botë, shpien njerëzit të harrojnë se ata do të mund të përdorin pasuritë e kësaj bote vetëm për 60-70 vjet, nëse kanë aq jetë të paracaktuar, e atëherë do t’i lënë mbrapa shtëpitë, veturat dhe fëmijët e tyre. Ata nuk mendojnë se do të varrosen të vetmuar. Gjatë gjithë jetës së tyre ata kanë vrapuar për pasuri në të cilën kurrë nuk do të kënaqen.

Sidoqoftë, ata që e konsiderojnë pasurinë si shpëtimtare dhe e neglizhojnë ekzistencën e Krijuesit të tyre do të vuajnë në të dy botët: **“Është e vërtetë se atyre që nuk besuan nuk do t’u vlejë asgjë para Allahut, as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata vetë janë lëndë e zjarrit.”** (“Ali Imran”, 10)

Kur’ani lajmëron fundin e atyre që shfaqin lakmi të pashuar ndaj pasurisë: **“Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet, e mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm! Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të hidhet në Hutame. E çka di ti se ç’është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që**

depërton deri në loçkë të zemrës. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme.” (“Humeze”, 2-9)

Pasuria e vërtetë u takon atyre besimtarëve që kurrë nuk kanë shfaqur interes personal në pasuritë e kësaj bote dhe që me të vërtetë besojnë se vetëm Allahu i jep të gjitha njeriut. Këta në të vërtetë janë njerëzit e pasur në këtë botë; ata nuk e kufizojnë jetën e tyre në vetëm 50-60 vjet. Besimtarët angazhohen në tregtinë më të mirë me arritjen e Xhenetit në këmbim me jetën e kësaj bote. Ata preferojnë pasurinë e amshueshme në vend të asaj të përkohshme. Allahu na informon në lidhje me këtë në ajetin në vijim: **“Allahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me Xhenet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. (Allahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Teurat, Inxhil e Kur’an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzohuni tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukseksi i madh.”** (“Teube”, 111) Ata që kapen pas kësaj jete, së shpejti do të kuptojnë qartë se kush është në rrugë të vërtetë.





Ky artikull do të jetë një përkujtim i disa çështjeve që ndihmojnë që të jesh në mesin e fitimtarëve në Ramazan duke i përdorur ditët dhe netët tuaja ashtu siç duhet. **“Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi.”** (51:55)

1. Muxhehdeh: Përpjekje kundër nefsit
“E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t’i orientojmë rrugës për te Ne” (29:69)

A dëshiron udhëzim? A dëshiron paluhatshmëri? Përpiqu kundër vetes tënde, se nëse ne e afrojmë veten afër Allahut, Allahu do të na afrohet neve.

2. Të kesh synim dhe vendosmëri të lartë
 Ibn Xheuziju ka thënë: “Shenja e mendjes së përsosur është synimi i lartë, se ai që është i kënaqur me synim të ulët është i nënçmuar dhe nuk kam parë mangësi aq të ashpra, sa ajo tek njerëzit të cilët kanë mundësi ta përmbushin (një vepër), por prapë nuk synojnë për të.”

3. Ti njohësh virtytet e këtij muaji dhe karakteristikat dalluese të tij
 Ai që e njeh një gjë e zhvillon interesimin për të dhe e ruan atë. Edhe nëse nuk do të kishte diçka në Ramazan, përveç Lejletul Kadr (natës së fuqisë), e cila është më e mirë

se 1000 muaj, ajo do t’i mjaftonte. **4. Ta dish se Ramazani është vetëm disa ditë dhe se ai shpejt ndahet prej teje** **“(Jeni të detyruar për) ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë.”** (2:184)

Dje ne i uronim njëri-tjetrit për fillimin e Ramazanit dhe sot e ngushëlojmë njëri-tjetrit për ndarjen nga ai. Ja kështu janë që të dyja, dita dhe jeta, kalojnë shpejtë. Pra, ngutu që të përfitosh në Ramazan.

5. Njerëzit e devotshëm garojnë në kryerjen e veprave të mira.
 Njerëzit e devotshëm garojnë për vepra të mira, ndërsa të tjerët janë të burgosur pas qejfeve të tyre dhe robër të epsheve të tyre. **“Pastaj, Ne u lamë në trashëgim Librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë me ndihmën e Allahut, të parët në punë të mira, e kjo është ajo mirësia e madhe.”** (35:32)

6. Ta kujtosh vdekjen dhe të kesh kujdes nga rastësia e saj.
 Ndoshta nuk e arrin Ramazanin tjetër, pra, ki kujdes për veten!

Ibrahim ed-Duvejsh

Koncepti i kauama-s

(Autoriteti i burrit)



Ky është një koncept i cili bazohet në ajetin: “**Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.**” (“Nisa”, 34)

Disa njerëz mendojnë se me këtë autoritet (kauama) të cilin Zoti ua ka njohur si të drejtë burrave, është bërë padrejtësi dhe është fyer gruaja. Sipas tyre, ai është një tregues i qartë i mungesës së barazisë së pretenduar mes burrit dhe gruas në ligjet dhe dispozitat e sheriatit.

Në fakt, nuk është ashtu siç kanë aluduar, gjë të cilën do e shtjellojmë në disa pika si më poshtë:

Së pari: Kauama (autoriteti) i cili përbën dhe burimin e parë të këtij aludimi, në thelb, nuk është gjë tjetër veçse menaxhimi dhe administrimi i familjes. Kur themi që filanit i është besuar “kauama” e kësaj shtëpie apo institucioni, do të thotë se ai ka në dorë administrimin e tij. Kushdo që udhëheq një organizatë apo lëvizje, ai është përgjegjës për mbarëvajtjen e saj.

Nëse kjo është e qartë, tani shtrojmë pyetjen: Vallë ku buron urtësia e

Ligjvënësit të Plotfuqishëm në ligjërimitin e “kauamas”, pra menaxhimit dhe udhëheqjes në shtëpi, organizatë, një qendër apo një lëvizje? Autoriteti në fjalë, mos është epiqendra e dinjitetit dhe e nderit, të cilin Zoti i Lartësuar, Ligjvënësi i Gjithëpushtetshëm e paska kufizuar vetëm për krijesën e Tij më të privilegjuar, burrin, duke privuar gruan? Qoftë dhe spontanisht, themi që nuk është kështu. Në fakt, është vullneti i Ligjvënësit dhe përkujdesi i Tij që fryma e sistemit dhe e disiplinës të karakterizojë të gjithë shoqërinë në çdo cep të saj dhe në çdo rrethanë. Por, rregulli dhe disiplina dominojnë në një shoqëri vetëm kur funksionojnë rregullat dhe respektohen përgjegjësitë. E këto përgjegjësi nuk do të respektohen siç duhet, veçsen nën hijen e një udhëheqësi, i cili merret me menaxhimin. Ky interes kaq i madh për dominimin e disiplinës dhe rregullit në çdo aspekt të jetës sociale, manifestohet qartë në hadithin profetik: “Çdo tre veta në një udhëtim, të zgjedhin njërin si kryetarin e tyre.”

(Bejhakij, Ahmed, Hakim) Nëse të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm se një shoqëri formohet nga qelizat familjare, duhet të ndërgjegjësohemi që ai që e fuqizon rendin social, përfshirë frymën e përgjegjësisë dhe të menaxhimit, është pikërisht rregulli dhe disiplina e cila duhet të mbizotërojë në familje. Që aty buron dhe përhapet disiplina dhe rregulli në mbarë shoqërinë. Ligjvënësi dhe Sovrani i Plotfuqishëm, i Cili manifeston interes që tre veta mos të rrugëtojnë pa e zgjedhur një të parë, manifeston interes më të madh që një familje të mos jetojë pa një administrator, i cili kujdeset për çështjet familjare, qoftë dhe një orë në ditë. “Të zgjedhin njërin si kryetarin e tyre” nuk do të thotë domosdoshmërisht që ky i zgjedhuri, të jetë më i miri, më i devotshmi, më i dashuri tek Zoti. Kriteri themelor është që ky person të jetë i përgjegjshëm, të ketë aftësitë e duhura për menaxhimin e individëve sipas normave të shëndosha. Pra, “kauama” (autoriteti) brenda familjes sipas



Islamit, është autoritet përkujdesjeje dhe administrimi, jo autoritet dominimi, pushteti dhe zgjedhjeje. Veç kësaj, ky autoritet nuk është tregues i vetëepërsisë dhe gradës së lartë që ky person ka tek Zoti. Në fakt, ai duhet të jetë tregues i aftësive që gëzon ai që ka marrë përsipër përgjegjësitë.

Së dyti: Dikush mund të shtojë me kureshtje: Nëse qenka kështu, atëherë përse Sovrani i Plotfuqishëm e ka lënë "kauaman", pra administrimin dhe përkujdesjen e familjes, vetëm në dorën e burrave? Përse nuk i ka ngarkuar të gjithë familjarët me përgjegjësinë që ata të zgjedhin kë të duan dhe kë shohin më të përshtatshëm? Së fundmi, përse kjo përzgjedhje është justifikuar



me fjalët: **"Meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre."** ("Nisa", 34) Ky pasazh mund të shihet edhe si tregues për epërsinë e burrave në vetvete ndaj grave, pa marrë parasysh vlerat!

Përgjigja: Të thuash që burrat gëzojnë epërsi ndaj grave, bie ndesh në mënyrë të mprehtë me shumë tekste të qarta

dhe të prera të Librit të Zotit. Vetë Zoti i Lartësuar e thekson se burrat dhe gratë janë të barabartë në peshoren e afërsisë me Zotin. Ajo që i dallon dhe i diferencon ata, janë vetëm veprat e mira që bëjnë për hir të Tij.

Zoti i Lartësuar thotë në Kuran: **"Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: 'Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.'"** ("Al Imran", 195)

"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë s i p a s veprave më të mira që ka bërë."

("Nahl", 97)

"Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë

ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi." ("Nisa", 124)

Për ta sqaruar dhe shtjelluar më tej, Zoti në një ajet tjetër thotë: **"Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj**

Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (“Ahzab”, 35)
 “O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëditur dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (“Huxhurat”, 13)

Shohim që urdhri i Zotit i ka hedhur poshtë dallimet mes mashkullit dhe femrës, si dhe, ato mes kombeve, popujve dhe fiseve të ndryshme, në kontekstin e lidhjeve me Zotin. Diçka e tillë vihet re lehtësisht në ajetet e cituara më sipër. Atëherë, cili është kuptimi i duhur i ajetit: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”** (“Nisa”, 34)?

Të menaxhosh çështjet e familjes, të merresh me përkujdesjen dhe garantimin e mbrojtjes së saj nga çdo rrezik që i kanoset, përfshirë dhe shpenzimet për një jetë dinjitoze, radhitet tek funksionet sociale më të rëndësishme, madje dhe të shenjta. Këto detyra, nuk e çenojnë aspak detyrën tjetër të faljes së dhembshurisë dhe dashurisë, kushtimin e vëmendjes ndaj fëmijëve dhe kontributin për një jetë bashkëshortore sa më të lumtur.

Sipas mendimit tuaj, cili nga dy bashkëshortët është më i aftë të përmbushë detyrën e parë, në çfarëdo rrethane?

Padyshim që asnjë prej nesh nuk ka dhe dyshimin më të vogël që nëse anëtarët e familjes ndihen të kërcënuar nga një hajdut në mes të natës, është bashkëshorti ai që brof drejt rrezikut. Sakaq, gruaja s’mund të bëjë gjë tjetër, veçse të struket me fëmijët në një qoshe të sigurt të shtëpisë. Ky është realiteti dominant në shoqëritë tona në të gjithë sferat. Madje, mund të them se kjo ndodh tek të gjithë njerëzit me të gjithë mendimet dhe idetë e ndryshme. “Kauama” e urdhëruar prej Ligjvënësit të Plotfuqishëm, më shumë sesa thjesht një urdhër dhe një dispozitë, është një aktualitet që praktikohet anembanë. Kurse lidhur me pjesën e dytë të këtij aktualiteti, sipas të cilit i besohen burrit dhe jo gruas, përgjegjësitë më të rënda të familjes, kjo ka ndodhur për shkak të garancive të cilat sigurojnë femnilitetin e gruas, si dhe, i ruajnë dinjitetin dhe nderin. Prandaj, ajeti: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”** është në kontekstin e një aktualiteti, i cili na imponohet, më shumë se një konfirmim i një kodi ligjor të detyrueshëm. Dëshira dhe ëndrra e vërtetë e një gruaje është të gjejë tek i shoqi mbrojtësin dhe siguruesin e jetesës, jo thjesht dikë me të cilin të ndajë shtratin. E në fakt, autoriteti i ligjëruar nga Zoti, nuk është veçse ai që ëndërron gruaja.

Në fund, burimi i këtij autoriteti nuk ka të bëjë me statusin e privilegjuar të burrit tek Zoti, por ka të bëjë me avantazhet fizike të cilat e mundësojnë ta kryejë këtë mision në formën më të mirë. Kjo, shoqëruar me nevojat e familjes për përkujdesje dhe gatishmëri në rast se i çenohen interesat. E njëjta gjë vlen edhe për avantazhin fizik të gruas, lidhur me kujdestarinë, mëkimin dhe edukimin e fëmijës.

Muhamed Seid Ramadan El-Butij

SI TA RUAJMË SHËNDETIN GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT?



Gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit mënyra e të ushqyerit tonë

nuk duhet të dallojë shumë nga ajo normalja dhe duhet të jetë sa më e thjeshtë. Mënyra e të ushqyerit duhet të jetë e tillë që të ruajë peshën normale të trupit. Duke pasur parasysh orët e gjata të agjërimit, duhet të hamë ushqim që tretet ngadalë, i cili përbëhet nga elbi, gruri, misri, fasulja, orizi i papërpunuar etj., (të ashtuquajturat karbohidrate komplekse).

Ushqimet që treten shpejt janë ushqimet të cilat përmbajnë sheqer, miell të bardhë etj. (të ashtuquajturat karbohidrate të përpunuara).

Ushqimet e skuqura nuk janë të shëndetshme dhe ngrënia e tyre duhet kufizuar. Ato

shkaktojnë çrregullime të tretjes, dhembje në lukth dhe probleme me peshën.

Gjatë muajit të Ramazanit duhet t'i shmangemi ushqimit me shumë yndyrë, ushqimeve që përmbajnë shumë sheqer, ngrënies së tepruar, veçanërisht në syfyr dhe pirjes së tepruar të çajit gjatë syfyr, pasi çaji shkakton humbjen e mineraleve dhe elektroliteve të vlefshme nëpërmjet urinimit të sforcuar. Sa i përket pirjes së duhanit, ajo nuk është e shëndetshme dhe duhet të lihet plotësisht.

Nga ana tjetër, duhet të marrim karbohidratet komplekse gjatë ushqimit para agimit, që ushqimi të zgjasë më tepër duke e zvogëluar ndjenjën e urisë. Hurmat janë një burim i shkëlqyeshëm i sheqernave, i kaliumit dhe i magneziumit. Bademat janë të pasura me proteina dhe kanë pak yndyrë. Bananet janë burim i mirë i kaliumit, magneziumit dhe i sheqernave.



Gjithashtu, duhet të pimë sa më tepër ujë ose lëngje frutash ndërmjet iftarit dhe rënies në gjumë, që trupi të rregullojë nivelin e lëngjeve trupore me kohë.

Vështirësitë më të zakonshme të organizmit

Përgjumësia (ulja e tensionit të gjakut)

Djersitja e sforcurar, plogështia, lodhja, mungesa e energjisë, marramendja, zbehja dhe ndjenja e humbjes së vetëdijes janë simptoma që shoqërojnë "uljen e tensionit të gjakut". Kjo ka tendencë që të paraqitet në orët e pasdites. Qëndroni në ambient më të ftohtë, shtoni marrjen e lëngjeve dhe të kripërave.

Dhembja e kokës

Shkaqet mund të jenë: ndërprerja e marrjes së kafesë, angazhimi i tepruar

gjatë ditës, mungesa e gjumit, uria, e cila shtohet nga fundi i ditës. Kur shoqërohet me "tensionin e ulët të gjakut", dhembja e kokës mund të jetë mjaft e rëndë dhe po ashtu, mund të shkaktojë mundim dhe vjellje para iftarit. Filloni zvogëlimin e marrjes së kafesë një deri dy javë para fillimit të muajit Ramazan. Riorganizoni orarin tuaj gjatë muajit të Ramazanit, që të keni mjaft kohë për gjumë.

Ulja e sheqerit në gjak

Shkak mund të jetë marrja e tepruar e ushqimit me sheqerna, veçanërisht para agimit (syfyr). Në këtë rast, truri prodhon sasi të tepruar insuline, duke shkaktuar rënien e nivelit të sheqerit në gjak në orët e pasdites. Hani diçka para lindjes së diellit (syfyr) dhe kufizoni me këtë rast marrjen e tepruar të ushqimit me sheqerna, si dhe të lëngjeve.



Përse nuk i lejohej një myslimaneje të martohet me një jomysliman

Islami ia ndalon një myslimaneje të martohet me një jomysliman, sakaq ia lejon myslimanit të martohet me një ithtare të Librit. Në fakt, shkaku i këtij ligji islam është vetë fakti që Islami e njeh si fe si judaizmin ashtu dhe krishtërimin. Për rrjedhojë, Islami i kërkon bashkëshortit mysliman që ta respektojë fenë e bashkëshortes së tij që mund të jetë ithtare e Librit, si dhe simbolet e fesë së saj. Kjo, i garanton gruas të mos ndihet në siklet në shtëpinë e bashkëshortit të saj mysliman, madje të kryejë të gjitha detyrat që i detyron feja dhe besimi i saj. Ky është një ligj dhe normë të cilën nuk e hasim tek jomyslimanët karshi myslimanëve.

Myslimani lexon në Kur'anin fisnik: **"Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita."** ("Maide", 44)

"Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë" ("Maide", 46)

"I Dërguari beson në atë (Kur'anin) që

i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu, dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): "Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij"." ("Bekare", 285)

Gjithashtu, Kur'ani u bën thirrje të krishterëve dhe hebrenjve që të ndjekin ligjet e librave përkatës. **"...e kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i Allahut"** ("Maide", 43)

"Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur Allahu në të." ("Maide", 47)

Për rrjedhojë, bashkëshorti mysliman e ka detyrë që t'i plotësojë të gjitha kushtet të shoqes së krishterë apo hebrenje, të praktikojë ritet e besimit të saj. Madje, të shpenzojë pasurinë që ajo të mos ketë asnjë pengesë në kryerjen e detyrimeve fetare.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi tëdhe familjen e

tij!) pati nënshkruar një marrëveshje me të krishterët e Nexhranit, e cila vlente dhe për të gjithë të krishterët e tjerë. Në besën që Profeti u pati dhënë të krishterëve ndër të tjera thuhej: “Nëse një e krishterë jeton në shtëpinë e një myslimani si bashkëshorte, ai (myslimani) duhet ta pranojë të shoqen e cila i përket një besimi tjetër ashtu siç është. Veç kësaj, ta respektojë dëshirën e saj për të ndjekur klerikët dhe për të praktikuar ritet e fesë së vet, pa asnjë pengesë. Kushdo që e shkel këtë dhe i imponohet të shoqes në çështjet e fesë së saj, ka shkelur besën e Zotit, paktin e të Dërguarit të Zotit dhe do të njihet tek Zoti si gënjeshtar.”

Bazuar në këtë legjislacion të Kur’anit dhe të traditës profetike, disa studiues myslimanë mendojnë se është e ndaluar që burri mysliman qoftë edhe t’i kërkojë gruas së tij (të krishterë apo çifute) të pranojë Islamin, nga frika se ajo mund të ndikohet nga kjo.

Bazuar në këtë legjislacion të drejtë,

tolerant dhe të paprecedent, sahabi Hatib ibnu ebi Beltea në vitin 628, i qe drejtuar Mokakis – mbretit të koptëve të Egjiptit – pasi i kishte dorëzuar mesazhin e profetit Muhamed: “...dhe ne nuk ta ndalojmë fenë e Mesisë, madje, të urdhërojmë ta ndjekësh”.

Ky qëndrim i Islamit, i cili i njeh të gjitha të drejtat një bashkëshorteje jomyslimane të martuar me një mysliman, nuk ka ekuivalent dhe të ngjashëm tek jomyslimanët karshi myslimaneve. Që këtu, nëse një vajzë myslimane lidhet me një jomysliman, kjo përbën një kërcënim real për besimin dhe lirinë e saj fetare. E si mund ta respektojë atë dhe besimin e saj, dikush që nuk e njeh fenë dhe nuk i respekton simbolet të cilave ajo u beson?! Prandaj, në Islam dhe me një burrë të fesë së saj (mysliman) ajo është e mbrojtur, e sigurt që do ta mirëkuptojnë në qëllimet e saj. Në qarqet islame nuk gjen veçse respekt karshi simboleve fetare të tjera, e ndërsa në shumë vende të tjera nuk ndodh kështu.





Muaji i Ramazanit,

muaji i zbukurimit me vlera morale

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Çdokush që agjëron një ditë të nxehtë për hir të Zotit dhe atë e merr etja, Zoti i dërgon 1000 melekë për t’ia lëmuar fytyrën dhe për ta ndihmuar deri në kohën e iftarit, kur Zoti u thotë: O melekët e Mi! Dëshmoni se unë e kam falur atë!”.

Çdo adhurim nga adhurimet që ka bërë detyrë Zoti i Madhërishëm si: agjërimi, namazi, haxhi... etj., ka të mirat dhe dobisë e veta të shumta shpirtërore, edukative dhe shoqërore. Ato, përveç se janë adhurim ndaj Zotit, me anën e të cilave njeriu shpreh nënshtrimin e tij dhe afrimin me Zotin, kanë edhe ndikime rregulluese në procesin e ndryshimit të vetvetes e të edukimit shpirtëror, mbi sjelljet morale të njeriut dhe lidhjet e tij me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Feja islame nuk e detyroi adhurimin e agjërimin vetëm që njeriu të mos hajë, të mos pijë e të mos bashkohet me gruan, por e bëri për një mbrojtje të njeriut nga çdo gjë e ndaluar.

Sa të bukura janë çastet në agim, atëherë kur dashuria për adhurimin e

Zotit besimtarëve ua vjedh gjumin dhe ata i fton në takim me Krijuesin. Sa të lumtur janë ata agjërues të cilët në këtë muaj gjuhën e kanë të zënë vetëm me përmendjen e Zotit dhe vazhdimisht mendojnë për të ndihmuar dhe ushqyer nevojtarët. Padyshim që Xheneti është vendi i merituar për këta njerëz.

Në kohën kur sytë thellohen në gjumin e rëndë të natës, në zemrat e njerëzve të Zotit zgjohet dashuria për adhurim dhe lutje. Ata ngrihen nga shtrati butë dhe i qetë, marrin abdes dhe duke rënë në sexhde përballë Krijuesit Fuqiplotë, kërkojnë falje për gjynahet e tyre.

Në këtë botë plot me kriza dhe konflikte, si mundet që njeriu të arrijë lumturinë dhe kuptimin e vërtetë të jetës? Aktualisht jemi dëshmitarë se arritjet mahnitëse shkencore dhe teknologjike, megjithëse janë të dobishme dhe të nevojshme, nuk mund t’u përgjigjen nevojave shpirtërore dhe nuk mund të tregojnë rrugën e shpëtimit nga kjo humnerë dhe zbrazëti. Në shkollat materialiste, jeta kufizohet vetëm brenda lindjes dhe vdekjes. Këto shkolla njeriun e ftojnë për kënaqësi të pakufizuara në këtë jetë të përkohshme. Gjithashtu, shfrytëzimi

masiv i mundësive të kësaj bote njeriu nuk e ka dërguar në pikën e dëshiruar. Njeriu ka nevojë për një njohje dhe bindje tjetër për të gjetur rrugën e drejtë dhe të lumtur.

Njeriu është krijesë me prije të larta që vazhdimisht dëshiron zhvillim. Ai vazhdimisht ikën nga shkatërrimi dhe zhdukja dhe nëse ekzistenca e tij kufizohet vetëm me jetën në këtë botë, atëherë mbetet pa përgjigje një prej nevojave të tij esenciale, dëshira për ngritje dhe amshueshmëri. Për këtë

me vlera morale nën hijen e besimit dhe veprave të mira. Zoti Fuqiptotë u ka dhënë premtime të shumta besimtarëve dhe punëmirëve. Njëri prej këtyre premtimeve dhe lajmeve të mira është dashuria në mesin e njerëzve. Në suren "Merjem", ajeti 96 lexojmë: **"Nuk ka dyshim se ata që bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t'u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri."**

Nuk ka dyshim se besimi në Zot, ndikon pozitivisht në shpirtin, mendimin, fjalët dhe sjelljen e njeriut. Këto ndikime



arsye, kur njeriu në shkollat materialiste e vëren se jeta është e kufizuar vetëm në këtë botë të përkohshme, humb të gjitha shpresat dhe përballet me shqetësime dhe strese të mëdha sepse në këto kushte nuk mund të perceptojë një të ardhme të qartë për vetveten.

Wil Durant, në librin "Historia e civilizimit" shkruan: "Fetë, jetës së njerëzve i falin lulëzim dhe shpresë, kurse botës rregull dhe kuptim. Shkenca, megjithëse i ka mësuar shumë gjëra njeriut, nuk mund t'i sigurojë qëllimet dhe dëshirat e tij të amshueshme ashtu si feja".

Muaji i Ramazanit është muaji i zbukurimit

mund të reflektohen në formë të devotshmërisë, veprave të mira, fjalëve të drejta, besnikërisë dhe mirësisë. Nëse njeriu zbukurohet me këto veti, nuk ka dyshim se do të tërheqë vëmendjen e njerëzve të tjerë duke fituar edhe respektin dhe dashurinë e tyre. Të gjithë, në njëfarë mënyre, e kemi ndier se kur vdes ndonjë njeri i pastër dhe punëmirë, të gjithë e qajnë dhe e ndiejnë mungesën e tij, megjithëse njerëz të tillë mund të mos kenë patur ndonjë pozitë të lartë shoqërore. Në një hadith të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) thuhet: **"Kur Zoti do një**

rob prej robërve të Tij, i thotë Xhebrailit: Unë e dua filanin, dua je edhe ti. Edhe Xhebraili do ta dojë atë. Më pas, lëshon zërin në qiej duke thënë: O banorë të qiejve, Zoti e do filanin, duajeni edhe ju. Si rrjedhim, të gjithë banorët e qiejve do ta respektojnë dhe do ta duan atë njeri. Ky respekt dhe kjo dashuri do të reflektohet edhe në mesin e banorëve të tokës... ”.

Ky hadith, na bën të qartë se besimi dhe veprat e mira kanë reflektim të madh sa vetë gjithësia dhe rrezja e dashurisë që del prej saj e përfshin mbarë gjithësinë. Zoti i do punëmirët dhe ata janë të dashur edhe pranë banorëve të qiellit. Kjo ndjenjë shpërndahet edhe në mesin e banorëve të tokës. A thua ka ndjenjë më të ëmbël se ajo që njeriu të jetë i dashur në mesin e të mirëve e të të pastërve të kësaj gjithësie?!

Një njeri i urtë ka thënë: Ilaç i shpirtit dhe i zemrës janë pesë gjëra: Qëndrimi me njerëz të merituar, leximi i Ku'anit, barku i urit, qëndrimi zgjuar gjatë natës për namaz dhe lutjet drejtuar Zotit në agim të ditës.

Imam Aliu ka thënë: “Mos u bëj si ai që ëndërron lumturinë në botën tjetër, por nuk bën asnjë lëvizje dhe përpjekje. Mos u bëj prej atyre që e dinë se rruga në të cilën janë duke ecur është e gabuar dhe duhet të kthehen, por vazhdimisht e shtynë këtë vendim. Mos u bëj si ai që i do të mirët, por nuk vepron si ata, që nuk i do mëkatarët, por në vepra është njëri prej tyre.”.

Zoti njeriut i ka falur aftësi të ndryshme. Njerëzimi mund të ngrihet në majat më të larta, por edhe mund të shkojë në humnerë. Njeriu vazhdimisht ndodhet në luftë midis të mirës dhe të keqes. Në të njëjtën kohë, ai për nga natyra është i prirur drejt të mirës dhe të vërtetës dhe nuk e do të keqen dhe të padrejtën. Ajo

që njeriun e largon nga rruga e ndritur e udhëzimit është mëkati. Në përgjithësi, mëkati lëkund themelet e bindjes dhe të moralit të njeriut. Zoti Fuqiptotë, nëpërmjet ajeteve të Shpalljes, njeriun e ka njoftuar me rreziqet dhe dëmet e mëkatit duke mbrojtur natyrën e tij të pastër nga ndotja e mëkatit.

Poeti i madh iranian Mevlana, në lidhje me rrënjët e depërtimit të të këqijave në brendinë e njeriut ka një tregim shumë interesant:

“Një ditë një burrë mbolli një gjemb i cili pengonte rrugën e njerëzve. Njerëzit, sa herë që kalonin aty pranë, e qortonin atë njeri duke i kërkuar që ta shkulte atë gjemb. Mirëpo, ai nuk i përfillte reagimet e njerëzve. Gjemb, nga dita në ditë, i forconte rrënjët, kurse ai burri, nga dita në ditë, plakej dhe dobësohej më shumë. Aq shumë zgjati hamendja e atij njeriu për shkuljen e atij gjembi, sa që u forcua dhe u rrit aq shumë dhe njeriu më nuk mund ta shkulte atë në asnjë mënyrë”.

Mëkati ka ndikime shumë negative mbi shpirtin dhe marrëdhëniet shoqërore të njeriut. Shumica e problemeve dhe parregullsive janë rezultat i devijimit të njeriut nga mësimet dhe udhëzimet e Zotit. Mëkatet largojnë begatitë. Zemërngushtësia është një ndër pasojat e mëkatit. Feja islame thotë se rruga më e mirë për t’u çliruar nga pasojat e mëkatit dhe shqetësimet në këtë drejtim është pendimi. Nga ky aspekt, pendimi përpos që i mundëson mëkatarit çlirimin nga çrregullimet mendore dhe nga stresi, bëhet shkak edhe për përmirësimin e sjelljes dhe të shëndetit të tij psikik. Ejani pra, që në muajin e Ramazanit, muajin në të cilin mëkatet shkrihen dhe brendia pastrohet nga çdo papastërti, nga Zoti të kërkojmë falje dhe të kërkojmë që të na i hapë edhe ne dyert e mëshirës së Tij të pafund.



Gënjeshtra te fëmijët

Gënjeshtra përkufizohet me fjalët: "Diçka e thënë që s'është e vërtetë; pohim që nuk përputhet me të vërtetën, të cilën e di edhe vetë personi që e thotë. Gënjeshtra është një proces falsifikimi i të vërtetës, me qëllim mashtrimi." Këtë përkufizim e sollëm me qëllim që ta bëjmë sa më të kuptueshme nëse kemi të bëjmë me një gënjeshtër, apo diçka që i ngjan asaj.

A është gënjeshtra një sjellje e natyrshme, apo është diçka e fituar?

Askush prej nesh nuk lind bashkë me gënjeshtërën. Prandaj, ajo shihet si një sjellje e fituar siç është dhe thënia e të vërtetës. Pra, fillimisht dhe përfundimisht, gënjeshtra lind dhe zhvillohet në mjedisin përreth fëmijës, zakonisht familja.

A luan rol familja në kultivimin e gënjeshtërës tek fëmijët?

Padyshim që po dhe shembujt e mëposhtëm flasin më qartë për këtë:

1 – Krijimi i modelit të gënjeshtarit: thuaji që babi nuk është këtu; thuaji që është duke fjetur; thuaji që mami nuk ka ardhur okoma; vëllai ka vajtur në shkollë etj.

2 – Këmbëngulja për të thënë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën për çdo çështje, e madhe apo e vogël qoftë. Kjo bën që fëmija të gënjejë për të mënjanuar

ashpërsinë e prindërve.

Cila është mosha në të cilën mund ta klasifikojmë sjelljen si gënjeshtër?

Në përgjithësi, është mosha pesëvjeçare. Para kësaj moshe, fëmija nuk e bën dot dallimin mes realitetit dhe imagjinatës. Prandaj, i bëjmë padrejtësi nëse e përshkruajmë si gënjeshtar.

A është gënjeshtra një sjellje e përhershme apo diçka aksidentale që mund të ndryshohet?

Kjo varet nga ambienti përreth. Nëse ai e stimulon gënjeshtërën për vite të tëra, ajo shndërrohet në tipar thelbësor të personit. Por nëse ekzistojnë përpjekje të njëpasnjëshme dhe serioze për ndryshimin e kësaj sjelljeje, brenda një ambienti të përshtatshëm, ky tipar mund të ndryshojë.

Llojet e gënjeshtërës

1 - Gënjeshtra imagjinare. Atë e hasim kryesisht në fëmijërinë e hershme, për shkaket e mëposhtme:

-Paafësia e fëmijës para moshës pesëvjeçare për të dalluar realitetin nga imagjinata.

- Shumë lodra dhe lojëra të fëmijëve, përmbajnë gjëra të pavërteta.

- Fëmijët i shprehin ëndrrat dhe dëshirat e tyre. Kështu, fëmija që dëshiron që babai t'i blejë një biçikletë, i thotë të vëllait se babai ia ka sjellë biçikletën dhe se gjendet në oborr.

- Nga dëgjimi i përrallave mitologjike para gjumit.

Këto imagjinata të fëmijëve nuk kemi përse t'i quajmë gënjeshtër, madje as nuk kemi përse të shqetësohemi prej tyre. Ato nuk janë prirje për gënjeshtër patologjike më vonë.

2 – Gënjeshtër pështjelluese. Në këtë rast, e vërteta pështjellohet dhe ngatërrohet me ëndrrat e fëmijës. Kështu, atij i ngatërrohen gjërat dhe nuk e kupton nëse ka ndodhur me të vërtetë apo e ka parë në ëndërr. P.sh, një vajzë e vogël i ankohet nënës se roja i pallatit, ia mori lodrën dhe paratë dhe e qëlloi në fytyrë kur ishte duke luajtur para pallatit.

Nëna, mund ta besojë këtë, sidomos nëse roja është njeri i vrazhdë, prej të cilit mund të pritet një sjellje e tillë. Në fakt, vajza e vogël kishte parë në ëndërr sikur roja i kishte marrë lodrën dhe paratë dhe këtë e tregoi si të vërtetë. Aq më tepër që ajo e kishte frikë, për shkak të fytyrës së tij të vrenjtur. Me ta parë në ëndërr, ajo vajti tek e ëma dhe ia rrëfeu si të vërtetë. Kjo lloj gënjeshtre, fillon e zhduket me rritjen e fëmijës.

3 - Gënjeshtër kompensuese. Në këtë rast, fëmija gënjen kur ndihet më inferior se të tjerët që e rrethojnë. Ai mund të gënjejë edhe për të tërhequr vëmendjen, për t'u bërë qejfin prindërve kur ka dështuar të realizojë pritshmërinë e tyre në një punë të caktuar. Kështu, ai shpik gjëra që nuk i ka bërë.

Në këtë rast, lipset përkujdes për fëmijën, si dhe të kuptohen mirë nevojat e tij psikologjike. Është mirë që të gjenden metoda reale për të plotësuar këto nevoja, pa gënjeshtër. Në të kundërt, kjo do të shndërrohet në gënjeshtër kronike, madje mund të kthehet në përpjekje për të mashtruar dhe për t'ua hedhur

njerëzve kur të rritet.

4 – Gënjeshtër obsesive ose maniake.

Ajo ndodh tek ato fëmijë të cilët vuajnë nga dhuna e prindërve dhe mungesa e besimit mes tyre. Ngaqë janë të privuar nga shumë gjëra, ata përdorin gënjeshtër. Kështu, djali u thotë prindërve se mësuesi u ka kërkuar pesëqind lekë për zbulimin e klasës. Kur fëmija humbet besimin në ambientin përreth, ndihet i privuar dhe fillon e gënjen për të zotëruar sa më shumë gjëra që i pëlqejnë. Kjo lloj gënjeshtre, kërkon që fëmijës t'i afrohem emocionalisht dhe shpirtërisht, ta bëjmë të ndihet i sigurt dhe t'i falim besimin e munguar. Ne duhet t'ia plotësojmë nevojat, me qëllim që të mos detyrohet të bëjë hile dhe të gënjejë.

5 – Gënjeshtër imituese. Fëmija imiton njërin nga prindërit kur dëshiron ta ekzagjerojë diçka. Kështu, imiton babanë i cili e ekzagjeron me një aksident automobilistik, ku ka qenë vetë dëshmitar dhe fëmija, duke ekzagjeruar kontributin e tij heroik në shpëtimin e viktimave dhe të të lënduarve. Fëmija duke qenë në atë aksident, ku i ati në fakt nuk bëri ndonjë gjë të madhe, mësoi artin e të gënjerit pikërisht nga i ati.

Fëmija mund të gënjejë edhe ngaqë është familjarizuar me gënjeshtër, të cilën e ka parë si normale në familje. P.sh, nëna e merr fëmijën gjoja për të dalë për shëtitje, mandej, fëmija zbulon se gjithçka ishte një gënjeshtër, pasi ajo po e çon tek dentisti. Ose kur babai i premton një dhuratë dhe nuk ia blen.

6 - Gënjeshtër për të tërhequr vëmendjen.

Këtë lloj gënjeshtre zakonisht e përdorin dy tipe fëmijësh:

- Fëmija egoist dhe i llastuar, i cili dëshiron të mbetet në qendër të vëmendjes të të dy prindërve gjatë gjithë kohës. Prandaj, ai gënjen që të tërheqë vëmendjen e tyre, edhe pse kjo mund të shkaktojë zemërimin e tyre. E rëndësishme është që ai të ndihet në qendër të vëmendjes.

- Fëmija i lënë pas dore dhe i harruar, i cili kërkon të tërheqë vëmendjen

e të dy prindërve të shkujdesur dhe indiferentë. Duke qenë se ata janë dhënë pas vëllezërve të tij dhe me problemet e tyre të përditshme, ai nuk gjen formë tjetër për t'u bërë pjesë e "lojës" veçse duke gënjer, gjë e cila shkakton tension në familje dhe fokusim të vëmendjes prindërore tek ky fëmijë.

7 – Gënjeshtria si rrjedhim i urrejtjes dhe i dëshirës për hakmarrje. Motivi kryesor i kësaj gënjeshtre është ndjenja e urrejtjes, e neverisë dhe e dëshirës për t'u hakmarrë. Është shumë e përhapur mes vëllezërve të një familjeje.

Gënjeshtria të këtij lloji, shkaktojnë shumë probleme brenda familjes dhe në shoqëri, pasi mund të ndëshkohen dhe penalizohen njerëz të pafajshëm. Për këtë, duhet që familja dhe shkolla ta zgjidhin problemin me kujdesin më të madh, duke studiuar dhe motivet e vërteta. Në të kundërt, fëmija duhet dërguar te një specialist.

8 – Gënjeshtria e frikës nga ndëshkimi, ose gënjeshtria vetëmbrojtëse.

Kjo lloj gënjeshtre përbën 70 % të gënjeshtrave tek fëmijët, sidomos tek ata mbi gjashtë vjeç. Bazuar në këtë, konsiderohet si më e përhapura.

Fëmija detyrohet të gënjejë kur në familje, shkollë apo shoqëri zbatohet një rregullore dhe sistem shumë i rreptë. Kështu, fëmija gënjen për t'i shpëtuar ndëshkimit. Fillimisht ai gënjen dhe e refuzon akuzën që i vishet, mandej ia ngjijtë dikujt tjetër.

9 – Gënjeshtria si rezistencë ndaj pushtetit të rreptë. Këtë lloj gënjeshtre, fëmija e praktikon kur jeton nën pushtetin e rreptë të prindërve, të cilët i projektojnë rrugën që duhet të ndjekë për t'u arsimuar dhe si të sillët në jetë. Duke qenë se nuk i lejohej të bëjë zgjedhjet e veta, ai u bindet sipërfaqësisht dhe pas shpinës së tyre vepron sipas dëshirës së tij, duke e mbushur vakumin mes të jashtmes dhe të brendshmes me gënjeshtria. P.sh, kur nëna e pyet mbi detyrat e shtëpisë, ai përgjigjet se mësuesi nuk kishte ardhur atë

ditë, kështu nuk ka detyra. Kur pyetet mbi notën që ka marrë në provimin mujor, ai i jep testin ku ka korrigjuar notën, që t'i afrohet pritshmërisë së prindërve.

10 – Gënjeshtria sociale. Kjo formë përdoret si nga fëmijët, ashtu dhe nga të rriturit, për të justifikuar mungesën në një takim, apo për të shmangur disa presione shoqërore. Nuk është kusht që kjo formë gënjeshtre të jetë tipar i pandashëm i personit.

11 – Gënjeshtria patologjike, kronike.

Ajo është gënjeshtër e qëllimshme dhe kronike, ku fëmija e ndjen veten të motivuar për të gënjer në mënyrë të pavetëdijshme. Ai gënjen gjatë gjithë kohës, duke e shndërruar gënjeshtren në tiparin më dallues të tij në mesin e njerëzve me të cilët jeton. Këtu, gënjeshtria bëhet pjesë e një sistemi të çrregullt sjelljesh, si vjedhja, largimi nga shtëpia ose shkolla, dinakëria, mashtrimi, hilet dhe dhuna.

Ky rast ka nevojë për një trajtim psiko-social nga një specialist, para se ky sistem i çrregullt i sjelljeve të marrë natyrë kriminalistike dhe agresive ndaj shoqërisë.



GRUAJA & FACEBOOK-U



Të jesh grua me cilësi të mira dhe të kesh profil në Facebook, vepro kështu:

1. Të jesh grua sociale

Mos e bëj Facebook-un mjetin e vetëm për ta mbushur kohën e lirë. Cakto një kohë brenda ditës për shfletimin e Facebook-ut.

Shiko marrëdhëniet e tua ditore me prindërit dhe familjen tënde.

Mundohu t'i vizitosh ata në rend të parë, sepse ata janë më parësorë se shokët e tu në Facebook, në mënyrë që ta mënjanosh izolimin nga Facebook-u.

2. Të jesh nënë shëmbëlltë

Mos qëndro para Facebook-ut përderisa fëmijët e tu nuk kanë me çka ta mbushin kohën e tyre të lirë.

Rekomandohet të hysh në Facebook duke qenë fëmijët në gjumë apo duke parë televizor, gjatë kohës së tyre të caktuar.

Cakto një kohë për shoqërimin me fëmijët.

3. Të jesh zonjë e shkathët në shtëpi

Mos qëndro në Facebook para se të kesh mbaruar punët e shtëpisë dhe drekën.

4. Të jesh adhures e denjë

Namazi të jetë më parësor për ty, sepse asgjë nuk ndryshon nga faqja e Facebook-ut tënd derisa ti falesh.

Mos qëndro para Facebook-ut derisa nuk ke përfunduar leximin e pjesës tënde ditore nga Kur'ani dhe nga përmendjet (Dhikret) e përgjithshme.

Facebook-u është rrjet që lidh botën, e

mira e saj është e mirë dhe e keqja e saj është e keqe; kush e do të mirën nxiton drejt saj dhe e shfrytëzon teknologjinë për thirrje në rrugën e Allahut.

Ki kujdes! Të bësh shpërndarjen e lajmeve, të zbulosh të metat e njerëzve, të shikosh privatësitë e robërve të Allahut, si shikimi në fotot personale etj.

Allahu ka thënë: **"Mos spiunoni njëri-tjetrin..."** ("Huxhurat", 12)

Ndërsa profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "Mysliman është ai, nga i cili të tjerët janë të sigurt nga dora dhe gjuha e tij."

Facebook-u është një rast i mirë për t'u lidhur me dijetarët, thirrësit islam, kërkuesit e dijes, poetët, gazetarët dhe ata që ndikojnë në shoqëri pozitivisht drejtpërdrejt e jo me ndërmjetës.

Ti duhet ta shfrytëzosh me dinjitet këtë duke zgjedhur faqet dhe shokët e hajrit.

5. Të jesh grua e nderhme

Gruaja e nderhme është libër i mbyllur që nuk e lexon asnjë, përveç burrit që ka zgjedhur të ishte shoku i saj në jetë; mos e hap librin për çdokënd dhe të dhënat e tua personale mbajti larg tastierës së kompjuterit.

Allahu ka thënë: **"Juve do t'ju kujtohet se çka ju them, kurse unë çështjen time ia lë Allahut, Allahu me të vërtetë i sheh njerëzit."** ("Gafir", 44)

Salam

Përshëndetje të dashur fëmijë!

Muaji i Ramazanit erdhi me aromën e këndshme të lutjes dhe sofrës së syfyrit.

Erdhi, me flladin e ëmbël të ezanit dhe të iftarit.

Muaji i Ramazanit është muaji i mikpritjes së Allahut. Është muaji në të cilin pranohen lutjet. Muaji, në të cilin goftë edhe frymëmarrja dhe gjumi i agjëruesit konsiderohen adhurim. Në këtë muaj, punët e mira shpërblehen më shumë te Allahu Bujar.

Gëzuar muajin e Ramazanit!


Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: “Çdokush që lexon një ajet Kur’ani gjatë muajit Ramazan, është njëlloj sikur të këtë lexuar të gjithë Kur’anin”

Mina Mekami



Njohje me Kur'anin

Surja "El-Kadr"



Sure "Kadr" ka zbritur në Meke dhe është e përbërë nga 5 (pesë) ajete. Në këtë sure flitet për shpalljen e Kur'anit në natën e Kadrit dhe për rëndësinë, mirësinë dhe vlerat e kësaj nate. Profeti i nderuar Hz.Muhamedi (paqja e Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) thotë: "Çdokush që këndon suren "Kadr", ka shpërblim sikur të ketë agjëruar të gjithë muajin Ramazan dhe natën e Kadrit ta ketë kaluar në adhurim."

Në ajetin e parë të kësaj sureje thuhet: "Ne e zbritëm Kur'anin në natën e Kadrit". Mund të lindë pyetja e të mendohet: po ne na kanë transmetuar që Kur'ani ka zbritur për gjatë gjithë jetës së Profetit kohë mbas kohe?! Po! Është e vërtetë, Kur'ani ka zbritur gjatë 23 viteve, por më parë, ka zbritur i gjithi në zemrën e Profetit dhe kjo gjë ka ndodhur në natën e Kadrit. Në ajetin e dytë thuhet: "E ç'të bën ty të dish se çështë nata e Kadrit?" Ky ajet na bën të mendojmë së madhështija e kësaj nate është e tillë, sa që edhe vetë Profeti, para se t'i shpallej kjo sure, nuk kishte dije për madhësinë e saj. Ky ajet tregon se cila është nata e Kadrit, duke na bërë me dije se kjo natë është më e mirë se një mijë muaj përsa i përket vlerave



të adhurimit. Po ashtu, na këshillon dhe na shpjegon se në këtë natë të madhërishtme me urdhrin e Allahut zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për të caktuar çështje për gjatë gjithë vitit. "Me lejen e Allahut të tyre në (atë natë) zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibril) për secilën çështje". Po kështu, edhe pse fjala *Tenzul* - zbresin është folje e kohës së tashme, ajo shpreh vazhdimësinë e kësaj nate. Është e qartë se nata e Kadrit nuk ishte posaçërisht dhe vetëm për kohën e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), por është një urdhër i vazhdueshëm që përsëritet çdo vit. Sa i përket fjalës *Ruh* - shpirt ka të bëjë me një nga engjëjt që është më lart se engjëjt e tjerë. Po ashtu, dhe fjalia *Min kul'li emrin* - për secilën çështje na shpjegon se engjëjt vijnë për të na caktuar të mirat dhe bereqetin e kësaj nate. Pra, qëllimi i zbritjes së engjëjve në tokë është që ata të zbatojnë atë çka Allahu ka caktuar për robtë e tij. Në ajetin e fundit të kësaj sureje thuhet: "Ajo çka Allahu përcakton në këtë natë është paqe gjer në agim". Në këtë natë ka zbritur Kur'anit. Kjo natë është caktuar si më e mirë se njëmijë muaj, po ashtu mirësitë, mëshira dhe bereqetet e Allahut zbresin në këtë natë për të gjithë njerëzit.

Cila është nata e Kadrit?

Nuk ka asnjë dyshim se nata e Kadrit është në muajin Ramazan, por në cilën prej netëve të muajit Ramazan ka vënd për të diskutuar? Thuhet se është nata e shtatëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzetënjë, njëzetetretë, njëzeteshtatë dhe njëzetënjë. Por më të njohurat janë njëzetënjë, njëzetetretë dhe njëzeteshtatë. Në thëniet e Profetit lexojmë se ai vetë gjatë dhjetë ditëshit të fundit të muajit Ramazan rrinte gjithë natën zgjuar duke adhuruar Allahun.

Pyetje për konkurs:

- 1- Sa ajete ka surja "Kadr"; kjo sure është shpallur në Mekë apo Medinë?
- 2- Përse thuhet në këtë sure që nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj?
- 3- Përse zbresin në tokë atë natë engjëjt?
- 4- Në cilën nga netët e muajit Ramazan është nata e Kadrit?
- 5- Çfarë shpërblimi merr ai person që këndon suren "Kadr"?

Vëmendje: Ky konkurs nuk zhvillohet me llotari, por çdokush që u përgjigjet saktë këtyre pyetjeve do të shpërblehet nga Fondacioni i Kur'anit.



Kali i egër

Ae dini se kafshët janë të ndjeshme ndaj njeriut dhe e kuptojnë më së miri gjendjen shpirtërore të tij? Po ne, a i kuptojmë ndjenjat e tyre? JO! Për këtë arsye nuk arrijmë të krijojmë një lidhje me to. Ka njerëz që për shkak të dashurisë që kanë ndaj Allahut, përpiqen që edhe krijesat e Tij t'i duan. Këta persona i kuptojnë me shumë lehtësi ata dhe krijojnë një lidhje të ngushtë midis tyre, sa që kuptohen me njëri-tjetrin me anë të shenjave.

Tregimi që kemi për zgjedhur është treguar nga një ndër bashkëudhëtarët e Imam Hasan Askariut.

Një ditë prej ditësh, së bashku me Imam Askariun (paqja qoftë mbi të!) vajtëm te tregu i kuajve. I gjithë tregu gumëzhinte nga zhurmat e njerëzve dhe të kafshëve. Në momentin që Imami u fut në pazar, papritur, zhurma e njerëzve dhe e kafshëve u shua. Imami iu afrua një tregtari që po shiste një kalë të egër. Tregtari, për shkak të egërsisë së kalit, kish vendosur ta shiste kalin e tij me çmim të lirë. Imami e bleu kalin edhe pse ishte i egër dhe më urdhëroi që ta shaloja kalin. Unë gjithë frikë iu afrova dhe i vendosa shalën kalit. Por për çudi, kali nuk po ndihej. Po qëndronte shumë i qetë dhe nuk grindej. Tregtari, kur pa që kali po qëndronte i qetë, u pendua që e kishte shitur dhe kërkoi që t'ia rikthenim kalin. Imami më tha: "Shumë mirë, ktheja kalin!" Tregtari, sapo e zuri me dorë kalin, ai filloi të hingëllinte e të mos i bindej ashtu si më parë. Tregtari u mundua ta qetësonte, por më kot. Ne u larguam nga ai vend, por nuk zgjati dhe tregtari dërgoi dikë që ne të ktheheshim e të merrnim kalin, sepse ai ishte i egër. Imami i tha: "Po unë e di që kali është i egër." Ai iu afrua kalit e i kapi veshët kalit përsëri u qetësua.

Biharul Anuar



MË BUJAR SE HATEMI

Eshtë folur shumë, si dhe, janë treguar shumë ngjarje për Hatem Taitin. Shpresojmë që tregimi që ne kemi përzgjedhur t'ju pëlqejë. Hatemi ishte burrë shumë i pasur dhe njëkohësisht, ishte i njohur dhe për zemërgjerësinë dhe bamiëritë e tij. Një ditë e pyetën Hatemin nëse kishte takuar njeri më zemërgjerë dhe bamiërës se ai. Hatemi tha: "Po, kam takuar... Një ditë prej ditëve, ndërsa po udhëtoja me disa shokë, në mes të rrugës na mori uria dhe nuk kishim asgjë me vete për të ngrënë. Kur u afruam pranë një shtëpie, trokitëm në derë dhe një djalë i ri na hapi derën, na ftoi brenda. Kur e pa se ishim të uritur, nxitoi e theri një qengj dhe na e serviri për ta ngrënë. Ne e hëngrëm me një oreks të madh dhe na shijoi shumë. Unë e falënderova të riun për mundin, si dhe, i lavdërova gatimin. Shokët po ashtu, shprehën dëshirën se të kishin dhe një tjetër, do ta hanin me kënaqësi. Djali kur i dëgjoi këto fjalë, doli nga dhoma dhe u kthye pas një ore me disa qengja në dorë dhe i vendosi mbi tavolinë. Na ftoi të hanim përsëri. Unë dhe shokët e mi hëngrëm sa u ngopëm. Më pas, e pyeta të riun se sa qengja i kishin mbetur akoma. Ai m'u përgjigj: 'Ato çka pata, i thëra për ju.' Unë, kur e dëgjova këtë përgjigje, u zemërova shumë dhe i thashë: 'Përse e bërë këtë gjë? Ti çka pate e vure për ne dhe tani nuk të ka mbetur asgjë!' Djali i ri tha: 'Kur në shtëpi më vijnë miq, unë nuk i kursej ato çka kam.'" Pasi njerëzit e dëgjuan këtë ngjarje, e pyetën Hatemin: "Ti çfarë bërë, si reagove ndaj kësaj ngjarjeje?" -"Unë, më pas, i dhurova trembëdhjetë deve dhe pesëmbëdhjetë qengja." Shokët i thanë Hatemit: "Gjithësesi, ti u tregove me bujar se ai, sepse i shpërbleve shumë më tepër nga çka ju dha ai. Pra, ti e konsideron atë më bujar se veten?" Hatemi tha: "Po, ai është më bujar se unë, sepse ai çka kishte ma dha mua. Në këmbim unë po i jap një pjesë të pasurisë sime, jo gjithçka.



Kujtimet e mia

Dhurata me e mirë në botë

Kur mendoj për gjyshen time, gjithmonë e kujtoj me rroba të bardha duke u falur dhe të ulur mbi sexhade duke lexuar Kur'an. Ajo recitonte bukur dhe me një zë melodioz Kur'anin, sa që unë gjithmonë kisha dëshirë t'i ulesha pranë e ta dëgjoja me vëmendje. I kërkoja që të më mësonte edhe mua. Një ditë prej ditësh më tha: "Dëgjo bija ime, po të falësh namazin, ke lexuar dhe Kur'anin, sepse namazi nuk falet pa kënduar suret e Kur'anit." Atë ditë, gjyshja me durim, më mësoi fjalë për fjalë se si të falem. Unë nuk ua dija kuptimin e fjalëve që thoja. Ajo me qetësi e durim më shpjegoi kuptimin e tyre. Më thoshte gjithmonë: "Vajza ime, Kur'ani është Libri i jetës, na udhëzon në rrugë të drejtë."

Gjyshja më tregonte gjithashtu për jetën e profetëve të mëdhenj, si dhe, më komentonte disa nga ajetet kur'anore dhe unë mezi prisja që tregimet, si shpëtimi i Hz. Ibrahimit nga zjarri, ndërtimi i barkës së Hz. Nuhut, hedhja e Hz. Jusufit në pus nga vëllezrit e tij e shumë ngjarje të tjera t'i lexoja nëpër libra. Ajo, me një buzëqeshje të ngrohtë gjithmonë më thoshte: "Kur të mësosh të lexosh vetë suren

"Hamd" do të të bëj dhuratën më të bukur e më të mirë në këtë botë." Sado që unë e pyesja se cila ishte kjo dhuratë, ajo nuk më përgjigjej, vetëm buzëqeshte. Unë kisha shumë dëshirë të dija se cila ishte dhurata më e mirë në këtë botë? Ditët kalonin dhe më pas, unë me gëzim të madh u futa në klasën e Kur'anit. Dalëngadalë mësova shkronjat dhe kisha shumë dëshirë të mësoja sa më shpejt të lexoja për të mësuar se kush është dhurata më e mirë në botë.

Si mbarova së mësuar alfabetin, me ndihmën e gjyshes, mësova të lexoja suren "Hamd". Më në fund, dita e shumëpritur erdhi për mua. Gjyshja, shumë e lumtur, vajti tek dollapi i saj i vogël e nxori një kuti të vogël, më puthi dhe më tha: "Mirë vajza ime, sot është dita që duhet të mbaj premtimin tim dhe më drejtoi kutinë. Unë e emocionuar dhe e gëzuar e mora dhe e hapa. Në të ishte një Kur'an i vogël dhe shumë i bukur me kapak të verdhë. E hapa dhe pashë që ishte i shkruar me shkronja të mëdha dhe të qarta. Tanimë unë mund t'i lexoja fjalët e tij. Ashtu e emocionuar fillova të lexoja, mollëzat e faqeve të gjyshes ishin skuqur dhe sytë i shkëlqenin nga gëzimi. Që nga ajo ditë, Kur'ani u bë libri im i jetës dhe Kur'anin e vogël që gjyshja më dhuroi e mbaj gjithmonë me vete.



Djali i Nuhut

(paqja qoftë mbi të!)

Kenani ishte djali i Hz. Nuhut dhe shoqërohej me shokë të këqinj. Çdo ditë, kur ata uleshin bashkë, e ngacmonin Kenanin për të atin.

Elishe i thotë: Kenan, përse nuk i thua gjë babait. Javani i thotë: Po, ka të drejtë, përse nuk i thua që ai burrë plak të heqë dorë nga ajo ç'ka nisur? Kenani, si dëgjoji fjalët e shokëve, uli kokën. Shokët, sa herë e takonin, i flisnin për të atin dhe e tallnin atë. Ai ua priste se në të vërtetë, nuk kishte ditë që të mos bënte fjalë me të, porse plakun e kishte lënë mendja. Shokët nuk hiqnin dorë kollaj dhe i thonin me shpoti Kenanit: Ne si të vdesim, do të ringjallemi përsëri, sikur çelin bimët nga toka? Por më qesharakja nga të gjitha këto është ndërtimi i barkës së tij në shkretëtirë. Tershishi që



gjer më tani rrinte në heshtje tha: Kenan, përse i duhet plakut tënd kjo barkë 150 metra, kur personat që besojnë në atë çka ai thotë janë vetëm tetëdhjetë? Dhe sikur të ndodhë ndonjë përmytje, mjafton një varkë e vogël për t'i shpëtuar ata tetëdhjetë persona.

Kenani ia ktheu: Më besoni, jam lodhur nga punët e tija. Masheku, një nga shokët e Kenanit buzëqeshi dhe tha: Me të vërtetë, çfarë qëllimi ka babai juaj kur pretendon se është profet, para apo pushtet? Kenani i tundi kokën i mërzhitur dhe tha: Ah sikur të pretendonte për pushtet dhe para! Fatkeqësisht, nuk është në kërkim të asnjërës nga këto, përpos kësaj, ai çfarë ka, e ndan me të varfrit. Gjithë këtë e bën që të kënaqë Allahun,




Allahun që gjer më tani, se ka parë njeri. Në mbrëmje, Kenani u kthye në shtëpi. Ishte i mërzhitur dhe babai i tij, Nuhu, e vuri re shqetësimin e të birit dhe i tha: Përsëri të paskan mërzhitur shokët? Përse të bezdisin kaq shumë? Kenani i tha: Baba, ti me Zotin tënd po na turpëron. Nuhu ia ktheu: Kujdes me fjalët biri im! Zoti më ka përzgjedhur që të transmetoj mesazhet e Tij për njerzit dhe për mua s'ka nder më të madh se ky.

Çfarë nderi është ky? Çdo ditë njerëzit qeshin me ne kur na shohin në rrugë. Profeti buzëqeshi e tha: Shumë shpejt do të pendohen të gjithë për çka thonë. Sa keq! Do të jetë shumë vonë kur ata ta kuptojnë gabimin. Dita e gjykimit është afër. Kenani i zemëruar tha: Ti vetëm kërcënon me ndëshkimin e Zotit... Nuk e dëgjove se ç'tha Futi? Nëse thua të vërtetën, atëherë thuaj Zotit ta afrojë sa më afër ndëshkimin. Nuhu ngriti kokën nga qielli dhe tha: O Zot, fale këtë djalë për atë çka thotë, sepse ai këto i ka mësuar nga të paudhët. Nuhu iu afrua Kenanit e i tha: Unë nuk jam gënjeshtar dhe afrimi ose largimi i dënimit nuk është në dorën time, por në dorën e Zotit. Unë jam vetëm një i dërguar, lajmëtar nga ana e Zotit për të gjithë ju. Kenani që vazhdonte të ishte i zemëruar, i tha: Shiko përreth teje, a ka njeri nga të pasurit dhe pushtetarët të cilët besojnë në atë çka ti predikon? Ti ke mbledhur përreth vetes disa varfanjakë dhe mendon se besimi i tyre do të jetë i vlefshëm? Profeti tha: Mjafton të thuash: "Besoj në Zot!" dhe për mua është e mjaftueshme. Zoti e di më mirë zemrën e çdokujt. Unë nuk mund t'i largoj ata për arsye të varfërisë apo të pasurisë. Zoti im, nga krijesat e Tij kërkon besimin, bindjen, jo paratë. Kenani ia ktheu: Ti u premtan Xhenetin atyre që besojnë dhe i tremb me ndëshkim ata që nuk besojnë. Ki kujdes me atë çka thua se njerëzit do të rebelohen dhe do ta vënë në veprim atë çka ata mendojnë e do të të godasin. Dhe kam frikë se në atë moment edhe unë do të jem nga krahu i tyre. Profeti buzëqeshi e tha: Është e çuditshme biri im! Kur u thuhet njerëzve të binden e të besojnë në Zot, ata thonë: Prindërit tanë, gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë ishin idhujtarë dhe ne dëshirojmë të ndjekim hapat e tyre. Por në rastin tonë, kur babai dëshiron të të mësojë rrugën e drejtë, dëshiron t'i thyesh kokën! Biri im, unë ty të dua shumë dhe zemra më digjet për ty, ndaj të lutem që të bëhesh besimtar, si vëllezërit e tu. Zoti është Mëshirues dhe i fal gabimet. Këtë radhë Kenani i vendosi duart në vesh dhe tha: Të lutem baba, mjaft më! Mos thuaj më asgjë se i kam të mbushura veshët nga ato që thua. Nuhu tundi kokën ngadalë e tha: Biri im, sa të ngjashme janë punët e tua me këta jobesimtarë. Kenani i taposi veshët me duart e tij dhe u shtri të flinte. Nuhu u ngjit në anije së bashku me besimtarët dhe me kafshët që ishin ndarë në çifte. Niveli i ujit u ngrit dhe shiu filloi të binte. Profeti vështoi poshtë dhe pa Kenanin. Biri im, beso në Zot dhe ngjitu lart në anije, sepse sot nuk shpëton asnjë jobesimtar. Kenani tha: A e shikon këtë mal? Unë do të ngjitem lart e do të shpëtoj. Pa e mbaruar mirë fjalën, një dallgë e madhe e mori përpara Kenanin. Në këtë mënyrë, mori fund dhe jeta e Kenanit dhe për njerëzit u bë shembull. Kenani ishte djali i profetit, por shoqëria e keqe bëri që ai të largohej nga rruga e drejtë.



Majmunët që parfumosen

A e dinit që majmunët parfumosen? Po, po. Sipas kërkimeve të bëra prej shumë vitesh nga një studiues i majmunëve, u pa se majmunët e quajtur ndryshe majmunët akrobatë parfumosin sqetullat dhe trupin e tyre me gjethet e një peme që lëshon aromë të mirë. Majmunët akrobatë këtë gjë e bëjnë që të tërheqin njërëz, si dhe, të rrisin popullaritetin e tyre.




Dënimi i burrit të shëndoshë

Një person kish për qëllim që të udhëtonte me avion, por pesha e tij ishte 160 kg. Kur vajti te kompania ajrore për të blerë biletën, menaxherët i bënë matje zotërisë në fjalë dhe i thanë se ishte pamundur udhëtimi, sepse karrigja nuk e zinte. Kështu që, sipas tyre, ai duhej të merrte dy karrige. Zotëria kishte qëllim që ta denonconte kompaninë ajrore, sepse ai pretendonte se e kishin ofenduar me gjestin që ata bënë.



Grabitësi dhe gruaja e moshuar

Një grabitës makinash kishte qëndruar pranë një karburanti dhe po vëzhgonte personat që furnizoheshin me karburant. Në çast u afrua një makinë nga e cila doli një plakë e moshuar rreth 75 vjeçare. Grabitësi po ndiqte me vëmendje gruan e moshuar. Në çastin kur gruaja doli nga makina për të mbushur makinën me karburant, grabitësi menjëherë zuri vend tek timoni dhe u bë gati ta ndizte makinën. Gruaja e moshuar e vuri re menjëherë grabitësin dhe me shpejtësi i hodhi benzinën në kokë. Grabitësi i papregatitur nga gjesti i gruas së moshuar, u tremb dhe me shpejtësi i dha gaz makinës për t'u larguar, por nuk zgjati shumë dhe policia e zuri atë.



Gjeli i detit me fat

Një ditë, një gjahtar doli për gjah. Ai, së bashku me çiften e tij, zuri një gjel deti. Si e mori gjelin, e vendosi në frigorifer se nuk kishte kohë ta pastronte. Pasi kaluan dy ditë, e shoqja e gjahtarit hapi frigoriferin që të merrte gjelin e ta gatuate, por për çudi ajo vuri re se gjeli i detit ishte akoma gjallë. Ajo e çuditur tha: Kjo është mrekulli! Vendosi që gjelin e detit ta çonte tek veterineri. Veterineri i hoqi plumbin nga krahu gjelit të detit dhe u habit nga gjendja e tij.

Katër ditë i hipur mbi biçikletë

Një burrë i moshës 49 vjeçare kish vendosur që të thyente rekordin duke ecur me biçikletë që emri i tij të ishte në krye të listës. Ai qëndroi 85 orë i hipur mbi biçikletë, pra gati katër ditë. Një nga shokët e zotërisë që kish qëndruar aty gjatë garimit të tij thotë: Gjatë minutave të fundit të kësaj gare, për arsye se u lodh, ai nuk mundi që të vinte këmbët mbi pedalet e biçikletës, por megjithatë, i përshëndeti të gjithë të pranishmit. Pas garës, edhe atë e dërguan në spital që të ishte nën mbikëqyrjen e mjekëve.





Kujtime në sirtar

Në moshën 7 vjeçare kisha dëshirë të agjëroja dhe dëshirën time e realizova. Atë vit, muaji Ramazan takoi në një periudhë të nxehtë dhe dita ishte e gjatë. Nëna më zgjoi për syfyr dhe së bashku me të tjerët, hëngra syfyrin. Më pas, nëna më tha: Fli, sepse dita është e gjatë e do të lodhesh. Unë e dëgjova porosinë e nënës dhe ashtu bëra. Por për çudi, gjumi më doli në orën dhjetë të paradites. Isha shumë e gëzuar që po agjëroja dhe që agjërimin nuk e kisha prishur. Por papritur, u gjenda përballë një vështirësie dhe vrapova për te nëna: Sa kohë duhet për të ardhur iftari? Nëna më tha: Duhet shumë, por, nëse je e uritur ha diçka, se për ty s'ka gjë, se ti je e vogël. Por unë nuk kisha uri, por një problem tjetër dhe u largova nga nëna. Vajta të kaloj pak kohën në televizion, por përsëri qe e kotë, sepse unë përsëri vazhdoja të kisha probleme dhe herë pas here, pyesja nënën: Edhe sa kohë duhet për të hapur iftarin? Ajo më tha: Duhet edhe shumë, po nëse dëshiron, pi ujë dhe ik e pusho pak. Unë nuk kisha etje, tjetër gjë më shqetësonte. Megjithatë e dëgjova fjalën e nënës dhe vajta të pushoja pak. Mendova se mos e zgjidhja problemin tim duke fjetur pak. Kështu u përpoqa shumë që të më zinte gjumi. Kaluan disa orë. Mbasdite u zgjova me aromën e supës që nëna gatuate. Edhe pse kisha dhimbje të forta barku, nënës nuk i thashë gjë, por vazhdoja të agjëroja dhe orët e fundit të kësaj dite agjërimi, edhe pse kisha shumë vështirësi. Ezani u thirr, unë vrapova për në banjo, u qetësova shumë për faktin se po e kaloja problemin tim. Pasi dola nga banjo, nëna më tha: E dashur, ti nuk ke vajtur në banjo fare që nga momenti që ke agjëruar, përse? Unë iu përgjigja: Jo, nuk kam vajtur dhe ky ishte problemi im, se po të shkoja në banjo, do më prishej agjërimi. Nëna më përqafoi e më tha: E dashura ime, po agjërimi nuk prishet nëse shkon në banjo, vetëm nëse ha e pi. Tani eja e ha nga këto hurma. Gjatë gjithë kohës mendoj për vështirësinë që kalova në këtë ditë, si dhe, pse nuk e pyeta nënën se çfarë e prishte agjërimin.



Konkurs

- 1- Përmendni emrin e sures dhe ajetin e saj, ku myslimanët janë urdhëruar të agjërojnë?
- 2- Në cilën sure dhe ajet është përmendur që të agjërohet nga agimi deri në perëndim të diellit?
- 3- Gjatë agjërimin, nga cilat veprime duhet të largohemi?

Punët e dobishme që kam kryer gjatë ditës

Sot u shkërmoqa milingonave thërrime. Secila merrte nga thërrimet që shkërmoqja dhe i çonte në fole për të siguruar ushqimin e dimrit.

Sot vendosa që të shkruaj në fletore të gjithë punët që do të kryej dhe ato që nuk kam kryer; si për shembull, të vizitoj fqinjën time që është një grua plakë e shumë e shumë punë të tjera...

Sot i hodha ujë maces, ajo vinte çdo ditë tek oborri ynë. Unë e tremba shumë dhe ajo u largua. Për këtë gjë jam zemëruar e penduar shumë. I kërkoja Zotit të më falte për këtë gjest që bëra.

Sot ndihmova motrën e vogël që të mësonte vjershën përmendsh. Ne e lexuam atë disa herë dhe motra e mësoi.

Kam vendosur që sot e tutje të lexoj disa ajete kur'anore së bashku me komentimin e tyre. Kam dëshirë të di se për çfarë flet Zoti në Kur'an dhe çfarë këshillon për njerëzit.

Sot ishte dita e parë që unë bëra një program për veten time.

Po ashtu, sot është dita e parë që do të agjëroj.

Sa e gëzuar që jam!



Fladi i Mëshirës

Me rastin e ardhjes së muajit të Bekuar të Ramazanit,
Fondacioni i Kur'anit sjell për dëgjuesit,
edicionin e 9-të të emisionit **"Fladi i Mëshirës"**

për **30 ditë** në frekuencat **93.6 MHz**,
ose në **www.radionacional.al** çdo ditë
120 minuta para hapjes së iftarit.

Ejani të shijojmë bashkë minutat më të arta të këtij muaji,
në shoqërinë e pjesëve kur'anore, ilahive, haditheve,
temave të trajtuara me të ftuarit, rubrika e minirubrika të
shumta vetëm në valët e **Radio Nacional.**

93.6 MHz



www.radionacional.al

